



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 24/2020 regjistri (JR)
Datë 26.06.2020

Nr. 15 i vendimit
Datë 18.05.2022

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 18.05.2022, ditën e mërkurë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 253, datë 12.03.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 42 dhe neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, 7, 13, 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në ankim, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 253, datë 12.03.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe, për shkak të këtij funksioni, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe në nenin 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, iu nënshtrua procesit të rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) administroi raportet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Komisioni, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vendosi të përfundojë hetimin kryesisht vetëm për këtë kriter, duke arritur në konkluzionet si më poshtë.
 - i. *Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, gjerat “a” dhe “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*
 - ii. *Subjekti ka kryer deklarim të rremë në kuptim të nenit 33/5, gjerat “ç” e ligjit nr. 84/2016.*
 - iii. *Subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshme blerjen e pasurive të luajtshme apo të paluajtshme nga ana e saj apo e personave të lidhur me të, dhënieve të huave nga ana e saj apo e personave të lidhur me të tek të tretët, aftësinë financiare të të tretëve për kthimin e huave, krijimin e likuiditeteve nga ana e saj apo e personave të lidhur me të, si dhe mbulimin e shpenzimeve nga ana e saj apo e personave të lidhur me të për periudhën e rivlerësimit.*
 - iv. *Subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit, në kuptim të nenit 33/5, gjerat “d” e ligjit nr. 84/2016.*
 - v. *Subjekti nuk paraqiti prova, si dhe nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave dhe pasurive të saj, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*
3. Sa më sipër, Komisioni ka çmuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Nevrie Duka.

II. Shkaqet e ankimit

4. Kundër vendimit nr. 253, datë 12.03.2020, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin e saj në detyrë.

4.1. *Shkaqet ankimore me natyrë procedurale të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur konsistojnë si më poshtë:*

i. Vendimi i Komisionit është dhënë në shkelje të rënda të parimeve themelore procedurale, pasi ndaj gjyqtares është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në kuptim të nenit 42 e 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenit 6 të KEDNj-së, si dhe nenit 4, pikat 5 e 6, dhe nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

ii. Vendimi i Komisionit është dhënë në kundërshtim me parimet e një procesi të rregullt ligjor, pasi, duke paragjykuar çështjen, Komisioni vendosi të përfundojë hetimin për subjektin e rivlerësimit vetëm për kriterin e pasurisë, pa i nënshtruar vlerësimit edhe dy kriteret e tjera, atë të kontrollit të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, duke vënë në dyshim serioz paanësinë, në kushtet kur për konfirmimin në detyrë, duhet të ekzistojnë të gjitha provat që provojnë arritjet e nivelit të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kontrollin e figurës dhe atë të aftësive profesionale, kjo referuar nenit 59/1 të ligjit 84/2016.

iii. Gjykimi i subjektit të rivlerësimit është bërë në kundërshtim me Kushtetutën e ligjin, rrjedhojë e shkeljes së nenit 6 të Konventës për shkak se nuk është gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj, në kushtet kur anëtarëve të trupit gjykues të Komisionit, të përzgjedhur në kundërshtim me Kushtetutën e ligjin, me pamjaftueshmëri profesionale të tyre, kërkuar nga ligji.

iv. Komisioni ka trajtuar çështjen e subjektit të rivlerësimit në mënyrë të diferencuar pasi, për situata të njëjta objektive me subjekte të tjera të rivlerësimit, në rastet e tyre ka vendosur konfirmim në detyrë, ndërsa në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, ka vendosur të kundërtën. Mbajtja e standardeve të ndryshme nga Komisioni për subjektin e rivlerësimit, bën të besojmë në subjektivizmin e provave dhe fakteve në dosje gjyqësore.

4.2. *Shkaqet ankimore mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, në mënyrë të përmbledhur, janë si më poshtë.*

4.2.1. *Për pasurinë, apartament banimi, ndodhur në lagjen nr. {***}, rr. “{***}”, pall. {***}, kati {***}, Sarandë:*

i. Konkluzionet e Komisionit lidhur me pasaktësitë, nuk janë të vërteta, pasi subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë përdorur të ardhura për blerjen e kësaj pasurie, pasi e kanë pasur në posedim dhe e kanë deklaruar si adresë vendbanimi në deklaratat periodike të vitit 2011 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*.

4.2.2. *Për pasurinë, apartament banimi në emër të vajzës së subjektit të rivlerësimit, O. D., me sipërfaqe 100,2 m², {***}, Tiranë:*

i. Komisioni ka gabuar kur nuk ka marrë në përlllogaritje shitjen e truallit në vitin 2008, gjithashtu shtrirja në kohë për likuidimin e apartamentit nuk është siç e ka përlllogaritur Komisioni,

ku e gjithë vlera 45 mijë euro është likuiduar në vitin 2011, por në fakt shuma prej 10.000 eurosh është likuiduar në vitin 2014.

ii. Komisioni ka arritur në konkluzion të gabuar kur në vendimin e tij pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk ka justifikuar me burime të ligjshme këtë pasuri, për shkak se për shumën 70.000 euro, e cila rezulton nga shitja e truallit me sipërfaqe 400 m², nuk janë paguar detyrimet tatimore dhe kjo shumë nuk është deklaruar gjendje në banesë, si dhe nuk provoi me dokumentacion justifikues nëse shtetasi Z. H. i ka paguar shumën 70.000 euro.

iii. Subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat e përfituara në vitin 2008, në shumën 70.000 euro, nga shitja e tokës truall, janë totalisht të ligjshme, në përputhje të plotë me parashikimet ligjore të nenit “D” të Aneksit të Kushtetutës, si dhe me parashikimet ligjore të ligjit nr. 84/2016, dhe kjo pasuri/apartament, në emrin e vajzës, është krijuar me burim të ligjshëm me këto të ardhura.

4.2.3. Për pasurinë, *automjet “BMW X5”*:

i. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ky automjet është blerë me të ardhura nga burime të ligjshme, dhe ka provuar se së bashku me bashkëshortin, kanë pasur plotësisht mundësinë financiare për blerjen e këtij automjeti.

4.2.4. Lidhur me *automjetin, tip “Skrep”, në vlerën 15.000 euro, blerë në vitin 2007*:

i. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë kërkesën e subjektit të rivlerësimit, për marrjen e informacionit më të detajuar pranë Bankës Raiffeisen (ose Bankës së Kursimeve), sepse viti 2004 është viti i privatizimit të kësaj banke) dhe afati i ruajtjes së dokumentacionit bankar është 10 vjet.

ii. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nëse në analizën financiare do të përfshihen të ardhurat e përfituara nga puna e bashkëshortit, në shumën 3.000.000 lekë, atëherë do të rezultonte se familja Duka ka të ardhura të ligjshme për të blerë mjetin tip “Skrep”.

4.2.5. Lidhur me *të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit E. D.*:

i. Subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat e bashkëshortit janë përfituar nga marrëdhëniet kontraktore (të punës/shërbimit apo qirasë), të lidhura me shoqëritë tregtare të cilat i konfirmojnë këto marrëdhënie, si dhe shumat e përfituara. Sipas subjektit, referuar deklaratave noteriale dhe marrëveshjeve përkatëse midis bashkëshortit të saj dhe shoqërive “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, këto shoqëri kanë konfirmuar marrëdhëniet kontraktore, si dhe kanë marrë përsipër përgjegjësinë për pagimin e detyrimeve tatimore.

4.2.6. Lidhur me *analizën ekonomiko - financiare për vitet 2003-2016*:

i. Për mosdeklarimin e depozitës në deklaratën periodike të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit pretendon të jetë një lapsus, i cili në kushtet kur është plotësisht i verifikueshëm, nuk mund të konsiderohet se është kryer me dashje, si dhe nëse do të merren në konsideratë të ardhurat e

deklaruara të bashkëshortit, do të rezultojë se ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të krijuar këtë depozitë.

ii. *Lidhur me dhënien e huas në shumën 30.000 USD, subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, pretendon se bashkëshorti i saj, shumën e dhënë hua, e ka siguruar nga puna e ligjshme në emigracion, 20 vite më parë, para martesës, të cilën nuk mund ta provojë.*

iii. *Lidhur me dhënien e huas në shumën prej 5.000 USD, në vitin 2006, subjekti i rivlerësimit pretendon se mosdeklarimi i kësaj huaje në vitin 2006, është i paqëllimshëm dhe, nëse do të merren në konsideratë të ardhurat e bashkëshortit nga puna e kryer prej tij, si dhe të ardhurat e dërguara nga motra e saj në Angli, atëherë të ardhurat e deklaruara dhe të përfituara do të mbulonin shumën e dhënë hua.*

iv. *Mbi depozitimin e shumës 20.000 USD në Procredit Bank, datë 23.06.2006, subjekti i rivlerësimit pretendon se mospasqyrimi në analizën financiare të Komisionit të të ardhurave të bashkëshortit në vitet 2005 dhe 2006, të ardhurat e kthyer dhe të dhëna hua nga bashkëshorti në vitin 2005, të ardhurat e kthyer nga motra e saj, e nxjerrin në konkluzion të gabuar vendimmarrjen e Komisionit. Për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji kryerjen e një analize të re financiare.*

v. *Lidhur me të ardhurën nga shitja e automjetit “Mercedes Benz”, subjekti i rivlerësimit pretendon se, referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, nuk parashikohet se fitimi i realizuar nga individët, nga shitja e automjeteve, është një e ardhur e tatueshme, në këtë kuadër, Komisioni nuk mund ta kategorizojë këtë të ardhur si të tatueshme.*

vi. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se si burim i dhënies së huas në shumën 39.307 USD, kanë shërbyer të ardhurat e përfituara nga shitja e truallit në shumën 70.000 euro. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, pretendon se po të merren në konsideratë të ardhurat e saj, gjendja e *cash*-it, si dhe kursimet e kryera gjatë viteve, do të kishte mundësinë për të mbuluar shumën e dhënë hua. Subjekti pretendon se Komisioni, në kundërshtim me ligjin, i ka kërkuar të vendosë në dispozicion dokumentacionin provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të huamarrësit, z. S., dhe arsyen për çfarë e ka përdorur huan.*

vii. *Lidhur me kreditë në shumat 700.000 lekë dhe 400.000 lekë, përkatësisht në datat 20.04.2010 dhe 28.5.2014, në Bankën Raiffeisen, subjekti i rivlerësimit pretendon se arsyeja e mosdeklarimit të këtyre kredive është fakti se këto kredi ia ka kaluar vëllait të bashkëshortit dhe nuk e ka konsideruar dhe deklaruar si detyrim, por njëkohësisht as si të ardhur, pasi ato kredi nuk janë përfituar dhe përdorur nga ana e saj, janë shlyer e mbyllur nga A. D. dhe A. D..*

viii. *Subjektit i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit duke pretenduar se ka deklaruar kursime ndër vite.*

ix. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se mosdeklarimi i dhënies së huas në shumës 15.000 euro, në deklaratën *vetting*, është harresë dhe nuk ka pasur për qëllim fshehjen e saj, duke sjellë praktikën e Komisionit dhe Kolegjit, se harresat të cilat nuk kanë si qëllim fshehjen, mund të kuptohen pasaktësi në kuptim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

5. Trupi gjykues i Kolegjit vendosi shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbi gjendjen që janë aktet, konform ligjit 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, pasi, referuar shkaqeve procedurale të ankimit dhe akteve të paraqitura, nuk ndodheshim në asnjë rast përpara kërkesave të nenit 51 të ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Lidhur me aktet shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur ankimit, për të cilat subjekti kërkoi marrjen e tyre në cilësinë e provës, trupi gjykues vlerësoi se nuk ndodhemi në kushtet e nenit 47 të ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe në nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

A. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet procedurale të ankimit

6. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është dhënë në shkelje të rënda të parimeve themelore procedurale, pasi ndaj gjyqtarës është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 e 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenit 6 të KEDNj-së, si dhe të pikave 5 e 6 të nenit 4, pikës 1 të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

6.1. Nga shqyrtimi i akteve shkresore të përcjella nga Komisioni në funksion të shqyrtimit të kësaj çështjeje, trupi gjykues konstaton se subjektit të rivlerësimit i është dhënë mundësia të paraqesë shpjegime dhe prova, fillimisht në përgjigje të pyetësorëve, më pas, në përgjigje të barrës së provës, të përcjellë me rezultatet e hetimit administrativ, dhe më tej me shpjegimet dhe sqarimet e dhëna në seancën dëgjimore të zhvilluar në Komision. Nga përgjigjet e pyetësorëve, rezulton që Komisioni ka kërkuar sqarime dhe dokumentacion justifikues mbi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave privatë periodikë dhe deklaratën e pasurisë vetting, si dhe mbi përgjigjet e pyetësorëve të mëparshëm. Rezultatet e hetimit administrativ dhe analiza financiare janë bazuar në të dhëna të ekstraktuara nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacioni i administruar gjatë procesit të rivlerësimit.

6.2. Trupi gjykues, në analizë të sa më sipër, vëren se Komisioni ka pasqyruar qartë rrethanat dhe faktet, si dhe ka kryer një analizë juridike, ekonomiko-financiare shteruese të provave të administruara, për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë shkak ankimi, nuk qëndrojnë. Duke pasur parasysh parimet për një proces të rregullt ligjor, referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese¹ dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut², mbi gjykimin kontradiktor dhe barazinë e armëve, për rëndësinë e veçantë që merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësitë e arsyeshme që u jepen palëve për të paraqitur deklaratimet, provat dhe vlerësimet ligjore të lidhura me çështjen që shqyrtohet, sikurse e ka trajtuar edhe subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, në ankimin e saj, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit se Komisioni ka cenuar parimet e procesit të rregullt, nuk qëndrojnë, pasi janë të pambështetura në provat e administruara.

¹ Shih vendimin nr. 21, datë 16.04.2015; vendimin nr. 34, datë 29.05.2015; vendimin nr. 37, datë 30.06.2016 etj.

² Shih Ruiz-Mateos kundër Spanjës; McMichael kundër Mbretërisë së Bashkuar; Vermeulen kundër Belgjikës; Lobo Machado kundër Portugalisë; Kress kundër Francës etj.

6.3. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, duke pretenduar për shkelje të parimeve bazë të një procesi të rregullt ligjor, si standarde minimale kushtetuese, dhe atyre të vendosura nga GjEDNj-ja, i ngre vetëm si çështje, por pa i trajtuar ato, si dhe pa i lidhur me situatën/veprimin konkret gjatë procesit të rivlerësimit të saj në Komision. Sa më sipër, ky pretendim i ankueses mbetet në nivel deklarativ pasi nuk parashtron situatën apo momentin të cilin e konsideron si shkelje të ndonjë prej parimeve të procesit të rregullt, duke e bërë këtë shkak ankimi të paargumentuar e të pambështetur në prova.

7. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se vendimi i Komisionit është dhënë në kundërshtim me parimet e një procesi të rregullt ligjor, pasi, duke paragjykuar çështjen, Komisioni vendosi të përfundojë hetimin për subjektin e rivlerësimit vetëm për kriterin e pasurisë, pa i nënshtruar vlerësimit edhe dy kriteret e tjera, atë të kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, duke vënë në dyshim serioz paanësinë, në kushtet kur për konfirmimin në detyrë duhet të ekzistojnë të gjitha provat që provojnë arritjet e nivelit të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kontrollin e figurës dhe atë të aftësive profesionale, kjo referuar nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

7.1. Trupi gjykues vlerëson se Komisioni mund të bazojë vendimin edhe vetëm në një prej kriterëve të vlerësimit, pa dhënë zgjidhje përfundimtare në themel edhe për kriteret e tjera, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës rivlerësimi mund të kryhet edhe mbi bazën e një kriteri. Në kushtet kur konfirmimi në detyrë kërkon plotësimin me sukses të kontrollit në të tria kriteret, ndërsa moskalimi me sukses i qoftë edhe njërit prej kriterëve është shkak për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, hetimi për kriteret e tjera është i panevojshëm në dritën e efikasitetit të procesit dhe të rikthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

8. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka cenuar parimin e kontradiktoritetit në një proces të rregullt ligjor duke luajtur rolin e hetuesit, pastaj të gjykatës në vendimmarrje, pasi marrja e provave, administrimi i tyre, pra hetimi kryesisht në lidhje me kriteret që çmon Komisioni, dhe më pas dhënia e vendimit për subjektin e rivlerësimit po nga e njëjta trupë gjyquese e Komisionit, e kthen atë në një organ me natyrë të dyfishtë dhe, si i tillë, nuk duhet të përfitojë nga ky status në vendimmarrje.

8.1. Ky pretendim i subjektit të rivlerësimit gjithashtu gjen përgjigje gjerësisht në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit³, ku në vendimmarrje të mëparshme, ka vlerësuar se kompetencat e Komisionit për të kryer hetimin administrativ dhe për të dhënë vendimin janë në përputhje të plotë me natyrën e procesit të rivlerësimit, si një proces administrativ i nisur kryesisht, në përputhje me tagrat që i njeh Kushtetuta, Aneksi i saj dhe ligji nr. 84/2016 në kreun VII, “Procedura e rivlerësimit”, në të cilin përcaktohen kompetencat hetimore dhe vendimmarrëse të Komisionit. Sa më sipër, pretendimi i ngritur nga subjekti i rivlerësimit është i pabazuar.

Trupi gjykues sjell në vëmendje se funksionimi i organeve që kryejnë procesin e rivlerësimit është analizuar dhe gjetur në përputhje me të gjitha garancitë e nevojshme për zhvillimin dhe respektimin e një procesi të rregullt ligjor nga Gjykata Kushtetuese⁴ në vendimin nr. 2/2017 – paragrafët 38 dhe 67 – dhe nga Komisioni i Venecias⁵. Pretendimi i subjektit për cenim të parimit të paanësisë dhe, për rrjedhojë, të procesit të rregullt ligjor, për shkak se e njëjta trupë gjykimi heton dhe

³ Vendimi nr. 4, datë 09.02.2021, (paragrafi 8) i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

⁴ http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php

⁵ <https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx>

vendos, është i pabazuar, pasi në vendimin e GEDNj-së që i përket Xh. kundër Shqipërisë, në paragrafët 307 dhe 308 është konstatuar se mënyra se si funksionojnë institucionet e rivlerësimit i përmbush standardet e KEDNj-së, për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit nuk qëndron pasi nuk gjendet i mbështetur në ligj.

9. Subjekti pretendon se vendimi i dhënë nga Komisioni është pa dyshim i paragjykuar, pasi, krahasuar me të gjithë veprimtarinë e mëparshme të Komisionit, hetimi administrativ i zhvilluar ndaj subjektit të rivlerësimit, ka qenë më i shkurtër nga të gjitha çështjet e tjera, në rastin konkret hetimi ka zgjatur vetëm 3 muaj dhe vendimmarrja është dhënë brenda ditës.

9.1. Nga analizimi i akteve të Komisionit, rezulton se trupi gjykues i Komisionit, me vendimin nr. {***} të datës 18.11.2019, ka vendosur fillimin e hetimit administrativ për procedurën e rivlerësimit, duke e përfunduar hetimin më datë 28.02.2020, me vendimin nr. {***} të tij. Lidhur me këtë fakt, trupi gjykues vëren se kuadri ligjor dhe rregullator i këtij procesi nuk parashikon afat kohor minimal apo maksimal në kryerjen e hetimit administrativ ndaj subjekteve të rivlerësimit. Në rastin objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka vepruar në përputhje me Kushtetutën, ligjin nr. 84/2016 dhe rregulloren e Komisionit “Hapat proceduralë të unifikuar”, e ndryshuar, për rivlerësimin e subjekteve nga trupat gjykuese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

10. Subjekti pretendon se gjykimi ndaj tij është bërë në kundërshtim me Kushtetutën e ligjin, rrjedhojë e shkeljes së nenit 6 të Konventës, për shkak se nuk është gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj, në kushtet kur anëtarët e trupit gjykues të Komisionit, ishin të përzgjedhur në kundërshtim me Kushtetutën e ligjin, me pamjaftueshmëri profesionale të kërkuar nga ligji.

10.1. *Trupi gjykues sjell në vëmendje se përputhshmëria e veprimtarisë së institucioneve që kryejnë procesin e rivlerësimit me parimet e nenit 6 të KEDNj-së, në drejtim të garantimit të pavarësisë dhe paanësisë, është certifikuar në fillim të procesit nga Komisioni i Venecias⁶, ka kaluar testin e kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese⁷ dhe së fundmi edhe çështja e gjykatës së krijuar me ligj, është konfirmuar nga shqyrtimi në praktikë nga GjEDNj-ja, në vendimin që i përket Xh. kundër Shqipërisë⁸. Në këtë të fundit, GjEDNj-ja nuk konstatoi shkelje të nenit 6/1 të KEDNj-së lidhur me mënyrën e funksionit të Komisionit dhe Kolegjit. Përpos kësaj, në kushtet kur vendimi i Komisionit i nënshtrohet shqyrtimit të hollësishëm nga ana e Kolegjit, garancitë për një proces të rregullt ligjor dhe për një gjykim efektiv dhe të paanshëm, adresohen edhe nga Kolegji. Pretendimi për cenim të procesit të rregullt ligjor për shkak se e njëjta trupë gjykimi heton, shqyrton dhe vendos, është i pabazuar. Referuar jurisprudencës së GjEDNj-së, ndër të tjera në Morel kundër Francës, Hauschildt kundër Danimarkës etj., në kuptimin e nenit 6, paragrafi 1 i KEDNj-së, njohja e thelluar e dosjes nga gjyqtari nuk nënkupton një paragjykim që e pengon të konsiderohet si i paanshëm në momentin e gjykimit në themel dhe vlerësimi paraprak i të dhënave nuk mund të çojë në paragjykimin e vlerësimit përfundimtar⁹. Trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit lidhet me funksionimin dhe organizimin e institucioneve që realizojnë procesin e rivlerësimit, sipas*

⁶ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e).

⁷ Shih vendimet nr. 2/2017 dhe nr. 78/2017 - http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php.

⁸ <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%22tabview%22:%22document%22,%22itemid%22:%22001-208053%22%7D>.

⁹ Paragrafët 142 – 163 të udhëzuesit mbi nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut – e drejta për një proces të rregullt (aspekti civil) - https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_SOI.pdf.

parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, dhe jo me veprime apo mosveprime konkrete të Komisionit që lidhen me rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit individualisht.

10.2. Gjithashtu trupi gjykues thekson se një pretendim i tillë, për cenim të parimit të pavarësisë dhe paanësisë së Komisionit, si pasojë e mungesës në përbërje të tij të anëtarëve të cilët vijnë nga sistemi gjyqësor, është trajtuar edhe nga GjEDNj-ja, e cila në vendimin e saj në çështjen gjyqësore *Xh. kundër Shqipërisë* ka arsyetuar: [...] *Për sa i përket mospërfaqësimit të gjyqtarëve në detyrë në KPK, Gjykata në fakt ka theksuar nevojën për përfaqësim thelbësor të gjyqtarëve brenda organit përkatës disiplinor (shih Oleksandr Volkov). Kjo nevojë është edhe më e rëndësishme në procedurat e zakonshme disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sidoqoftë, Gjykata duhet të marrë parasysh natyrën e posaçme të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Ky proces mori jetë në përgjigje të nevojës urgjente, siç vlerësohet nga legjislatura vendase, për të luftuar nivelin e lartë të korrupsionit që kishte pushtuar sistemin e drejtësisë. Në kushtet kur mënyra e funksionimit të institucioneve të rivlerësimit u është nënshtruar tashmë filtrave të analizës së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk gjendet i mbështetur në ligj dhe, për rrjedhojë, nuk qëndron.*

- 11.** Shkarkimi i subjektit të rivlerësimit nga detyra është joproporcional me qëllimin e ndjekur dhe konkluzionet në të cilat është bazuar Komisioni, për shkak se masa e dhënë nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Është e qartë se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra të një gjyqtari apo prokurori përbën ndërhyrje në të drejtën e marrë në mbrojtje nga neni 8 i KEDNj-së, e drejta e respektimit të jetës private, për këtë arsye vijon pretendimi i subjektit se kjo ndërhyrje duhet të jetë e parashikuar në ligj, proporcionale dhe e nevojshme në një shoqëri demokratike.

11.1. Trupi gjykues vlerëson se edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron, pasi është i pabazuar. Sipas ligjit nr. 84/2016, parimi i proporcionalitetit dhe objektivitetit i referohet vlerësimit në tërësi të çështjes dhe synon që masa disiplinore të jetë në raport të drejtë me shkeljen e kryer nga subjekti i rivlerësimit. Konkluzionet për kriterin e vlerësimit të pasurisë së subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta dhe se nuk ka provuar bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të pretenduara, kanë përbërë mjaftueshëm elemente për Komisionin për të konkluduar se subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në zbatim të nenit 61, pika 3 e po këtij ligji.

11.2. Në funksion të shkakut të ankimit të mësipërm, trupi gjykues çmon se Kolegji, në vendimmarrjet e tij, ka arsyetuar se proporcionaliteti vlerësohet rast pas rasti, duke pasur parasysh disa aspekte, si: balancën mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik ose mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve; mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë; të drejtën e cenuar dhe synimin që kërkon të arrijë legjislatori. Nga dispozitat ligjore të parashikuara nga Kushtetuta, por edhe nga ligji nr. 84/2016, vërehet se ato i referohen aplikimit të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit për zgjidhjen e çështjes në tërësi, duke synuar që në rastet objekt vlerësimi në kuadër të rivlerësimit të subjekteve të këtij ligji, masa disiplinore e dhënë të jetë në përpjesëtim të drejtë me shkeljet e konstatuara. Në rastin e procesit të rivlerësimit, aplikimi i parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit nga organet e rivlerësimit, i çon këto organe drejt dhënies së një mase disiplinore e cila nxjerr subjektet jashtë sistemit të drejtësisë, bazuar vetëm në standarde

objektive, duke u siguruar që masa e dhënë të jetë e nevojshme për të përmbushur qëllimin e ligjit, si dhe në proporcion me shkeljet e konstatuara.

Referuar parashikimeve të nenit 4, pikat 5 dhe 7 të ligjit nr. 84/2016¹⁰ dhe nenit 52, pika 1 e të njëjtit ligj, “Barra e provës”, parashikohet: *Komisioni dhe Kolegji i Apelit në shqyrtimin e çështjes udhëhiqen nga parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit*. Parimet e proporcionalitetit dhe objektivitetit orientojnë vlerësimin në tërësi të çështjes duke synuar që masa disiplinore të jetë në raport të drejtë me shkeljen e kryer nga subjekti i rivlerësimit, si rrjedhojë ky pretendim i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar në prova dhe ligj.

11.3. Sa i përket pretendimit për cenimin e nenit 8, “E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare”, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili parashikon se: *1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. 2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve*, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit në ankim, nuk ka përcaktuar se cili veprim i Komisionit ka shkelur këtë parim të procesit të rregullt ligjor.

- 12.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka trajtuar çështjen e subjektit të rivlerësimit në mënyrë të diferencuar, pasi, për situata të njëjta objektive me subjekte të tjera të rivlerësimit, në rastet e tyre ka vendosur konfirmim në detyrë, ndërsa në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, ka vendosur të kundërtën. Mbajtja e standardeve të ndryshme nga Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, e bën atë të besojë në vlerësimin subjektiv të provave dhe fakteve në dosjen gjyqësore.

12.1. Trupi gjykues vëren se barazia para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjtoja për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia në ligj dhe para ligjit presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se dallimi në trajtim do të konsiderohet diskriminues, në vështrim të standardeve të nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, kur ai [...] nuk ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, pra kur ai nuk ndjek një “qëllim të ligjshëm” ose kur nuk ekziston marrëdhënie e arsyeshme dhe përpjesëtimore ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet, pra barazia në ligj dhe para ligjit presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta; në këto rrethana, trupi gjykues e gjen të pambështetur pretendimin e subjektit të rivlerësimit.

- 13.** Sipas subjektit të rivlerësimit, legjislatori ka përcaktuar si shkak shkarkimi që lidhet me pasurinë vetëm pikën 1 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pra vetëm kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishin e pasurisë së paligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë dhe personin e lidhur me të, ndërsa pika 3 e nenit 61 që përbën shkakun e shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, lidhet me

¹⁰ “Komisioni dhe Kolegji i Apelit ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. “E drejta e informimit, e parashikuar në ligjin “Mbi të drejtën e informimit”, mund të kufizohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë për administrimin e procesit të rivlerësimit”.

konceptin e deklarimit të pamjaftueshmërisë, por kjo pamjaftueshmëri sipas subjektit të rivlerësimit duhet të lidhet njëkohësisht si me kriterin e pasurisë, ashtu dhe me kriterin e figurës. Pra, kushtet e nenit 61, pika 3 janë kumulative, fakt që rezulton qartësisht nga interpretimi logjik i kësaj dispozite.

13.1. Në lidhje me këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka konkluduar për mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, duke e kualifikuar situatën sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe jo sipas nenit 61, pika 1 që parashikon sanksionin për rastet në të cilat vërtetohet dyfishi i pasurisë së ligjshme, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është trajtuar tashmë gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit¹¹, ku është theksuar se pavarësisht se deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë dhe figurës janë përmbledhur në normimin ligjor të pikës 3 të nenit 61, bazuar në përcaktimin e qartë që jep Aneksi i Kushtetutës për këto dy kritere, nuk mund të pretendohet se aplikimi i tyre duhet të interpretohet në mënyrë kumulative. Deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë përbën një zbatim të përcaktimeve kushtetuese të nenit D të Aneksit të Kushtetutës në nivelin e ligjit, i cili parashikon detyrimin për subjektin e rivlerësimit që të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, prandaj këto dy kritere nuk kërkojnë doemos praninë e njëri-tjetrit për t'u vërtetuar deklarimi i pamjaftueshëm.

14. Në përfundim të analizës së pretendimeve për shkelje të parimeve procedurale të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në ankim, nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosjen e Komisionit, trupi gjykues nuk konstaton veprime apo mosveprime të Komisionit të cilat të kenë cenuar të drejtat e subjektit për një proces të rregullt ligjor. Për sa më lart, trupi gjykues e konsideron të panevojshëm kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe zhvillimin e debatit me praninë e subjektit të rivlerësimit, pasi nuk konstaton ndonjë nga rastet e parashikuara prej nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012¹².

B. Vlerësimi i Kolegjit për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe shkaqet e ankimit lidhur me të

15. Lidhur me pasurinë “apartament”, ndodhur në lagjen nr. {***}, rr. “{***}”, pall. {***}, kati {***}, Sarandë”, në posedim që prej vitit 2010, për të cilën subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuara konkluzionet e Komisionit për deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

15.1. Komisioni ka konstatuar problematika që lidhen kryesisht me faktin se: i) subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë “vetting” vlerën e apartamentit, si dhe sipërfaqen e tij; ii) deklarimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, në deklaratën e kontrollit të figurës nuk përputhet me deklarimin e saj në deklaratën e pasurisë “vetting”, për sa i përket kohës së fillimit të banimit të subjektit në këtë apartament; iii) deklaratimet e subjektit në lidhje me punimet e kryera

¹¹ Paragrafi 22.15 i vendimit nr. 19/2019 (JR); paragrafi 32, vendimi 21/2020 (JR).

¹² Neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 parashikon: “1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë”.

nga bashkëshorti i saj, nuk përputhen me deklaratën noteriale të znj. B., deklaratë kjo e depozituar nga vetë subjekti, iv) subjekti nuk ka depozituar asnjë dokument ligjor për të provuar posedimin e këtij apartamenti, si dhe subjekti nuk e ka deklaruar posedimin mbi këtë apartament në asnjë nga deklaratat e interesave privatë periodikë; v) rezulton e dyshimtë marrëdhënia juridike e subjektit me këtë pasuri; vi) subjekti është në kushtet e konfliktit të interesit; vii) subjekti nuk provon me dokumentacion ligjor të drejtën e pronësisë mbi këtë apartament; viii) subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë “vetting” në mënyrë të plotë dhe të saktë këtë pasuri; ix) subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshme krijimin e kësaj pasurie.

Në përfundim të analizës së fakteve dhe provave, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, geramat “a” dhe “b”, si dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

15.2. Lidhur me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, pretendon se në deklaratën e pasurisë “vetting”, ka deklaruar posedimin e këtij apartamenti, pasi kjo pasuri nuk është në pronësi të familjes së saj, kësaj as ajo dhe as bashkëshorti i saj nuk kanë përdorur ndonjë burim të ardhurash për krijimin e saj. Subjekti i referohet deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.01.2020, të paraqitur si provë gjatë hetimit administrativ në Komision, ku përfaqësuesi i shoqërisë i ka kaluar të drejtën e përdorimit të kësaj pasurie në këmbim të punëve që do të kryente bashkëshorti për këtë shoqëri, pavarësisht se kryerja e këtyre punimeve nuk u bë e mundur. Subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, konfirmon faktin se ka vazhduar ta përdorë apartamentin në mirëkuptim me përfaqësuesin e shoqërisë, me të cilin, sipas saj, ka edhe lidhje miqësie familjare.

15.3. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim aktet e administruara në fashikujt e përcjellë nga Komisioni, konstaton se subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, në deklaratën e pasurisë “vetting”, ka deklaruar: *Aktualisht posedoj një apartament (ku jetoj prej qershorit të vitit 2010, ndodhur në rrugën “{***}”, pall. {***}, kati {***}, Sarandë, me pronar J. B., me të cilin bashkëshorti im ka bërë një marrëveshje verbale që, në këmbim të vlerës së punës së gërmimit për pallatet e tij, të na japë këtë apartament. Akoma s’e kemi bërë hipotekimin.* Në lidhje me përcaktimin e kohës së fillimit të banimit në këtë apartament, rezulton se në përgjigje të pyetësorit nr. {***}, datë 31.01.2020, subjekti i rivlerësimit deklaroi se banon në këtë apartament që prej muajit qershor 2010 dhe deri më sot.

15.4. Nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.12.2019, nënshkruar nga z. J. B. dhe bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. E. D., konfirmohet fakti se apartamenti me sipërfaqe 76 m², i ndodhur në Sarandë, në lagjen nr. {***}, në katin e gjashtë të objektit (kati i shtatë banim), posedohet nga subjekti i rivlerësimit prej muajit qershor 2010¹³. Me qëllim verifikimit e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, Komisioni, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 29.01.2020, i ka kërkuar informacion shoqërisë “{***}” ShPK lidhur me marrëdhënien kontraktore me subjektin e rivlerësimit, si dhe mënyrën e përfitimit të këtij apartamenti nga ana e saj. Nëpërmjet përgjigjes nr. {***}, datë 25.02.2020, kjo shoqëri konfirmon se nuk ka asnjë marrëveshje të shkruar me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, z. E. D., duke

¹³ “[...] Unë, J. B., në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë “{***}” ShPK, deklaroj se në qershor 2010, apartamentin e ka marrë në dorëzim z. E. D., ndërsa kontratën e kalimit të pasurisë do ta bëjmë vetëm pasi të kemi rakorduar për vlerën e punimeve të kryera prej tij në trojet që shoqëria ka ndërtuar objekte [...]”.

deklaruar se ka vetëm një marrëveshje verbale me të, ku në këmbim të punimeve që do të kryheshin me mjetin e tij *skrap* dhe vetëshkarkues për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK për një periudhë 10-vjecare, do të përfitonte apartamentin për një vlerë prej 38.000 eurosh dhe, në rast se marrëveshja (verbale) nuk do të përmbushej, palët do të riktheheshin në gjendjen e mëparshme, duke i lindur detyrimi subjektiv të rivlerësimit të paguante një qira mujore prej 100 eurosh, nga muaji qershor 2010, periudhë në të cilën subjekti i rivlerësimit ka filluar të jetojë në këtë apartament.

15.5. Sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.01.2020, të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, ku deklarues është administratorja e shoqërisë “{***}”, znj. M. B., dhe bashkëshorti i subjektivit të rivlerësimit, vërtetohet fakti se punimet në këmbim të të cilave do të përfitohej apartamenti në të cilin jeton subjekti i rivlerësimit prej më shumë se 10 (dhjetë) vjetësh, nuk janë kryer nga ana e bashkëshortit të subjektivit të rivlerësimit, z. E. D.¹⁴.

15.6. Trupi gjykues vëren se, bazuar në nenin 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, ku përcaktohet se: *“Pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektivit të rivlerësimit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të paraqesë të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Pretendimi i subjektivit se e ka deklaruar përdorimin mbi këtë apartament në deklaratat periodike duke vendosur adresën në këto deklarata, është i pamjaftueshëm dhe në kundërshtim me përcaktimet e nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”¹⁵, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”).*

15.7. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor për të provuar posedimin e këtij apartamenti nga ana e saj për një periudhë kaq të gjatë kohore, por ka paraqitur vetëm 2 (dy) deklarata noteriale të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit, për të cilat tashmë Kolegji ka një qëndrim të konsoliduar në jurisprudencën¹⁶ e tij, sa i përket vlerës së tyre provuese për efekt të këtij procesi. Nisur nga kontradiktat e deklarin të subjektivit të rivlerësimit mbi burimet e krijimit të kësaj pasurie, krahasuar me deklaratat e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë “{***}” ShPK, trupi gjykues i konsideron si jo të sinqerta deklarin e tij dhe arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektivit të rivlerësimit mbi mënyrën e

¹⁴ [...] Është fakt që pas vitit 2011, shoqëria “{***}” ShPK nuk është pajisur me leje ndërtimi për të ndërtuar ndonjë objekt në qytetin e Sarandës dhe për këtë, që prej vitit 2011, nuk na është dhënë mundësia që t’i japim ndonjë porosi z. E. D. për të kryer punime gërmimi [...]. Ne deklarojmë se kemi rënë dakord që nëse ne si shoqëri, deri më 30.12.2021, nuk marrim leje ndërtimi, atëherë do të bëjmë marrëveshje të re për të përcaktuar mënyrën e likuidimit të çmimit të apartamentit prej 38.000 eurosh nga z. E. D. [...].

¹⁵ Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil [...].

¹⁶ Vendimi nr. 6/2018(JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 12.09.2018, paragrafët 35 dhe 36; vendimi nr. 11/2019(JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 22.05.2019, paragrafi 27.12.1; vendimi nr. 34/2019(JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 02.12.2019, paragrafi 85.2.

përdorimit të këtij apartamenti (vetëm me një marrëveshje verbale) është jobindës dhe i pabazuar në prova. Për sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për burimin e krijimit të kësaj pasurie, në kuptim të nenit 33/5, geramat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

16. Lidhur me pasurinë e paluajtshme “Apartament në emër të vajzës (O. D.) së subjektit të rivlerësimit me sipërfaqe 100,2 m², ndodhur në {***}, Tiranë, blerë në shumën 45.000 (dyzet e pesë mijë) euro, për të cilën subjekti i rivlerësimit e konsideron të gabuar konkluzionin e Komisionit se nuk ka justifikuar me burime të ligjshme blerjen e kësaj pasurie, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

16.1. Komisioni ka konstatuar se ky apartament është deklaruar për herë të parë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, në vlerën 45.000 euro, vit në të cilin është pasqyruar blerja e apartamentit në analizën financiare. Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kanë shërbyer të ardhurat e përfituara nga shitja e tokës truall në Sarandë. Duke qenë se apartamenti është deklaruar për herë të parë në DPV/2011, në vlerën 45.000 euro, sipas Komisionit vlera prej 70.000 eurosh, e përfutuar nga shitja e truallit në vitin 2008, nuk rezulton e tatuar, kjo vlerë e përfutuar nga shitja e truallit nuk rezulton e deklaruar gjendje në DPV/2008, por as në deklaratat pasardhëse. Komisioni vendosi që në analizën financiare të vitit 2011, të mos përfshijë si të ardhur shumën 70.000 euro. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshme krijimin e pasurisë apartament, të ndodhur në {***}, Tiranë, duke kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të kësaj pasurie, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, geramat “a” dhe “b”, si dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

16.2. Lidhur më të ardhurat e ligjshme për blerjen e këtij apartamenti, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka gabuar kur nuk ka marrë në përlllogaritje shitjen e truallit në vitin 2008, me arsyetimin se nuk janë paguar detyrimet tatimore, kjo shumë nuk është deklaruar gjendje në banesë, si dhe nuk provoi me dokumentacion justifikues nëse shtetasi Z. H. i ka paguar shumën 70.000 euro. Kjo shumë, sipas subjektit të rivlerësimit, është totalisht e ligjshme, në përputhje të plotë me parashikimet ligjore të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe me parashikimet ligjore të ligjit nr. 84/2016, sipas subjektit kjo pasuri/apartament në emrin e vajzës, është krijuar me burim të ligjshëm me këto të ardhura. Po kështu, subjekti i rivlerësimit pretendon se shtrirja në kohë për likuidimin e apartamentit nuk është siç e ka përlllogaritur Komisioni, ku e gjithë vlera 45 mijë euro është likuiduar në vitin 2011, ku në fakt shuma prej 10.000 eurosh është likuiduar në vitin 2014.

16.3. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mori në shqyrtim dokumentacionin e administruar në dosjen gjyqësore lidhur me këtë pasuri, nga ku konstatoi se subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë “vetting”, në rubrikën “Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit”, deklaroi: *Apartament në emër të vajzës sime O. D. me sipërfaqe 102,2 m², regjistruar me nr. pasurie {***}, vol {***}, f. {***}, {***}, Tiranë, blerë me një pjesë të shumës të nxjerrë nga shitja e tokës 400 m², vlera 45.000 (dyzet e pesë mijë) euro, kurse në deklaratën periodike vjetore për vitin 2011, ka deklaruar: Një apartament 2+1 në katin {***}, me nr. {***}, hyrja {***}, kulla {***}, me sipërfaqe 102,2 m², ndodhur në {***}Tiranë, e pahipotekuar ende (blerë me një pjesë të shumës së përfutuar nga shitja e truallit që kishim në Sarandë), në vlerën 45.000 (dyzet e pesë mijë) euro. Ky apartament është përfutuar nëpërmjet kontratës së shitjes (pasuri e paluajtshme) nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 08.09.2014, midis palës shitëse, z.*

A. Rr., dhe palës blerëse, O. D. (Pëlqimdhënësit E. D. dhe Nevrie Duka), ku në nenin 3 të kësaj kontrate, “Kushtet e Kontratës”, konkretisht në pikën 3.5, citohet se: *Pala blerëse ka likuiduar të gjithë vlerën prej 45.000 (dyzet e pesë mijë eurosh), a) palët deklarojnë se likuidimet i kanë bërë dhe nuk kanë asnjë detyrim ndaj njëri-tjetrit dhe pala blerëse e ka likuiduar totalisht këtë vlerë në 2012.*

16.4. Pavarësisht se kontrata e shitjes është lidhur në vitin 2014, subjekti i rivlerësimit pretendon se vlera e apartamentit është shlyer 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro në vitin 2011 dhe 10.000 (dhjetë mijë) euro në vitin 2014, sipas mandatarkëtimit nr. {***} serie, viti 2011, nga i cili rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka arkëtuar shumën 35.000 euro, me përshkrimin: *arkëtim kësti ap. {***}, kati {***}, korpusi {***}*; dhe mandatarkëtimi nr. {***}, datë 08.09.2014, ku rezulton se bashkëshorti ka arkëtuar shumën 10.000 euro, me përshkrimin: *arkëtim kësti ap. {***}, kati {***}, korpusi {***}*. Trupi gjykues, ndodhur përpara deklaramë kontradiktore të subjektit të rivlerësimit në deklarin periodik të vitit 2011, në pyetësorin nr. {***}, datë 05.02.2020¹⁷, dhe në ankimin e paraqitur në Kolegj, me ato të pasqyruara në kontratën e shitjes nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 08.09.2014, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor kreu analizën financiare për mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur për krijimin e kësaj pasurie, në dy variante. Në variantin e parë, duke konsideruar shumën prej 45.000 eurosh të likuiduar të gjithën në vitin 2011, sipas deklarin të subjektit të rivlerësimit, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka një diferencë negative në shumën 5.702.479 lekë, për të përballuar shpenzimet dhe për të krijuar pasuri për vitin 2011. Në variantin e dytë, duke konsideruar shumën prej 45.000 eurosh të likuiduar totalisht në vitin 2012, sipas përcaktimit në kontratën e shitjes, nga ku subjekti i rivlerësimit rezultoi me një mungesë burimesh financiare në shumën 6.663.167 lekë. Pavarësisht sa më sipër, në Kolegj u krye përlllogaritja edhe bazuar në likuidimet e pagesës për këtë pasuri, referuar mandatarkëtimeve ku pagesa prej 35.000 eurosh është kryer në vitin 2011, dhe pagesa prej 10.000 eurosh është kryer në vitin 2014. Rezultatet e analizës financiare për këto dy vite treguan që subjekti i rivlerësimit ndodhet në pamjaftueshmëri burimesh financiare në shumën 4.303.832 lekë për vitin 2011 dhe 3.295.705 lekë për vitin 2014.

17. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për konsiderimin si të ligjshme të shumës prej 45.000 eurosh, si e ardhur që buron nga përfitimi i shumës prej 70.000 eurosh, si rezultat i shitjes së truallit në vitin 2008, trupi gjykues çmon se fillimisht duhet të merret në analizë e ardhura e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit nga shitja e këtij trualli. Në funksion të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues analizoi deklarinet e subjektit të rivlerësimit ndër vite, nga ku rezultoi se në deklaratën e pasurisë “vetting”, subjekti i rivlerësimit në rubrikën “Përshkrimi i pasurisë dhe krijimi i pasurisë”, ka deklaruar: *Tokë truall me sipërfaqe 400 m², marrë nga Bashkia Sarandë në vitin 1999 nga Nevrie Halo (Duka) dhe shitur me kontratë sipërmarrjeje nr. {***} rep., datë 28.05.2008; në deklaratën periodike të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Truall 400 m², vlera 300.000 lekë, me pjesë takuese 100%, në zonën “{***}” H{***}, P{***}, reg. {***}, f. {***}, dt 3/5/01, blerë nga Bashkia Sarandë me të ardhurat e mia; në deklaratën periodike të vitit 2008 subjekti ka deklaruar: *trualli prej 400 m², ndodhur në P. {***} bl {***}, në kanalën e {***}, Sarandë, iu shit z. Z. H. në shumën 70.000 (shtatëdhjetë mijë) euro.***

¹⁷ “[...] Me shitjen e truallit, menjëherë u dhanë 35.000 mijë euro [...] pagesat u bënë me lekë në dorë dhe ato mandatarkëtime na u dhanë në një kohë tjetër, thjesht për të pasur një dokument për çdo të papritur [...] pjesa tjetër e shumës së mbetur u shlye me lidhjen e kontratës përfundimtare [...]”.

17.1. Nga aktet e përcjella në Komision nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Sarandë me shkresën nr. {***}prot., datë 31.12.2019, dhe Bashkia Sarandë me shkresën nr. {***} prot., datë 20.03.2020, për pasurinë (truall), rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka përfituar truallin prej 400 m² me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. {***}, datë 28.08.1999 dhe me kontratën e shitblerjes nr. {***}, datë 04.09.2000, subjekti e ka blerë këtë truall në vlerën 288.000 lekë nga Bashkia Sarandë. Në vendimin e Këshillit Bashkiak citohet se trualli prej 400 m² i jepet znj. Nevrije T. Halo si investitor i sheshit të ndërtimit, në këtë vendim janë përcaktuar dhe kondicionet urbanistike të objektit që do të ndërtohet. Në kontratën e shitjes së truallit e cila ka bazë ligjore ligjin nr. 7980, datë 27.07.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, është përcaktuar se trualli do të përdoret për ndërtim hotel turizmi. Subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime gjatë hetimit administrativ në Komision, por dhe në ankimin e paraqitur, mbi arsyen e përfitimit të këtij truall nga ana e Këshillit Bashkiak Sarandë, si dhe nuk ka shpjeguar pse nuk e ka përdorur për qëllimin e dhënë, i cili ka qenë ai i ndërtimit të një objekti.

17.2. Këtë truall, nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., {***}kol., datë 28.05.2008, pala pronare e truallit Nevrie Duka ka rënë dakord t’ia verë në dispozicion dhe t’i kalojë të drejtën për ndërtimin e objektit palës sipërmarrëse Z. H. H.. Në të njëjtën ditë me nënshkrimin e kësaj kontrate, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar edhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 28.05.2008, me anë të së cilës ia shet këtë truall z. Z. H. në shumën 70.000 euro, duke deklaruar se e ka marrë këtë shumë prej z. Z. H. në datën 26.05.2008.

17.3. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë bankare në Procredit Bank ShA, rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka depozituar shumën 70.000 euro më datë 01.07.2008, me përshkrimin: *e ardhur nga shitja e truallit*, dhe e ka tërhequr këtë shumë më datë 20.11.2008, së bashku me interesat e akumuluar në këto llogari bankare në shumën 730 euro, me përshkrimin: *tërheqje sipas njoftimit të bërë në datën 08.11.08 - CA Intra-branch Cash Withdrawal*.

17.4. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupit gjykues i rezulton se për truallin me sipërfaqe 400 m², regjistruar në ZRPP Sarandë me nr. pasurie nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, zona kadastrale {***}, pas nënshkrimit të deklaratës noteriale të sipërcituar, të jetë nënshkruar *kontratë e shitblerjes nr. {***}rep. nr. {***} kol., datë 18.03.2016*, me palë shitëse Nevrie Duka dhe palë blerëse z. Z. H., përfaqësuar me prokurën e posaçme nga z. F. R., ku në paragrafin “Çmimi i shitjes” të kësaj kontrate, citohet: *Palët deklarojnë se shitësja, pasurinë me të dhënat e mësipërme ia shet blerësit kundrejt çmimit në shumën totale në vlerën 70.000 (shtatëdhjetë mijë) euro. Palët deklarojnë mua noterit se blerësi ka likuiduar plotësisht çmimin e shitjes së pronës në shumën 70.000 euro në datën 26 maj 2008 që provohet dhe konfirmohet me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.05.2008*. Arsyeja e dhënë nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, për nënshkrimin në të njëjtën ditë të kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., {***} kol., datë 28.05.2008 dhe deklaratën e shitjes së këtij truall nr. {***} rep., {***}kol., datë 28.05.2008, vit në të cilin ka përfituar shumën prej 70.000 eurosh, është bërë pasi kjo pasuri në atë kohë nuk ka qenë e regjistruar në sistemin e ish-ZRPP, Drejtoria Vendore Sarandë dhe, për pasojë, nuk lejohej transaksioni i pasurive, arsye kjo që subjekti i rivlerësimit ka bërë kontratën e shitjes së këtij truall më datë 18.03.2016.

17.5. Lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore, subjekti ripretendon se vlera prej 70.000 eurosh është përfituar për shkak se në datën 28.05.2008, subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., me shtetasin Z. H. dhe me kontratën e shitjes nr.

{***}, datë 18.03.2016, kjo pasuri me sipërfaqe 400 m², nr. pasurie {***}, zonë kadastrale {***}, i ka kaluar blerësit Z. H.. Në këtë kontratë është përcaktuar se vlera e shitjes, e cila është likuiduar në datën 26.05.2008, e konfirmuar kjo dhe me deklaratën noteriale nr. {***}, datë 28.05.2008. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, meqenëse kalimi i pronësisë për këtë pronë është kryer në vitin 2016, në këtë moment ka lindur dhe detyrimi dhe është bërë pagesa e detyrimeve tatimore, ku bashkëlidhur ankimit ka paraqitur dhe dokumentin që vërteton pagesën e tatimit prej 1.406.850 lekësh.

17.6. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se është e dyshimtë kryerja e dy veprimeve juridike në të njëjtën ditë nga ana e subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë truall, lidhja e kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 28.05.2008 (në të cilën trualli i vihet në dispozicion sipërmarrësit për ndërtim) dhe nënshkrimi i deklaratës noteriale nr. {***}, datë 28.05.2008, nga e cila subjekti i rivlerësimit pretendon se ka shitur truallin dhe ka përfituar shumën prej 70.000 eurosh, ndërsa në përgjigje të pyetësorëve¹⁸ të Komisionit, lidhur me vënien në dispozicion të dokumentit provues të pagimit të detyrimeve tatimore për shitjen e këtij trualli, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nuk disponon dokument provues për pagimin e detyrimeve tatimore.

17.7. Lidhur me dokumentimin e përfitimit të shumës prej 70.000 eurosh, të vërtetuar sipas subjektit nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 28.05.2008, mbi shitjen e truallit prej 400 m², trupi gjykues vëren se nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është deklaruar si gjendje *cash* shuma prej 70.000 eurosh, në asnjë prej deklaratave periodike në vite, detyrim ky i përcaktuar në nenin 4, pika 1, gerrat “a” dhe “d” të ligjit nr. 9049/2003. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbi mosdeklarimin e gjendjes *cash* të shumës prej 70.000 eurosh, është i pabazuar në prova dhe ligj.

17.8. Në analizë të shkakut të ankimit se përfitimi i shumës prej 70.000 eurosh nga ana e subjektit të rivlerësimit në vitin 2008, është përfituar nga shitja e truallit prej 400 m², trupi gjykues, pasi analizoi dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ në Komision, vëren se shitja e truallit në vitin 2008, është bazuar në deklaratën noteriale nr. {***}, datë 28.05.2008, në kushtet e mungesës së një kontrate e cila përbën një nga burimet më të rëndësishme të lindjes së detyrimeve, pasi kontrata e tjetërsimit të pasurive të paluajtshme dhe konkretisht, kontrata e shitblerjes si veprim juridik të jetë e vlefshme, është e domosdoshme që të plotësohen të gjitha kushtet e parashikuara në nenin 663 të Kodit Civil dhe konkretisht: (i) pëlqimi i palëve; (ii) shkak i ligjshëm; (iii) objekti i kontratës të jetë i përcaktuar dhe i ligjshëm; (iv) forma e kërkuar ligjore. Një kusht i rëndësishëm që kërkohet për të krijuar kontratë të vlefshme është forma e saj dhe në mënyrë të veçantë kur kjo kërkohet shprehimisht nga ligji, pasi çdo formë e kontratës ka implikimet e saj në drejtim të tatimeve të aplikueshme, për sa më lart deklarata noteriale nuk përbën mjet ligjor për fitimin e pronësisë në kuptim të Kodit Civil. Në kushtet e mungesës së formalizimit të shitjes së truallit në vitin 2008 në një nga format e parashikuara nga ligji për kalimin e pasurisë së paluajtshme, *kontratë shitje*, trupi gjykues vlerëson se shitja e truallit dhe përfitimi i shumës prej 70.000 eurosh nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {***}, datë 28.05.2008, si dhe shoqëruar kjo me mungesën e pagesës së detyrimeve tatimore në vitin 2008 për këtë të ardhur, nuk mund të konsiderohet si burim i ligjshëm e ardhura e pretenduar si e përfituar nga shitja e truallit, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

¹⁸ Pyetësori nr. {***}, datë 12.12.2019, pyetja 4 (b).

17.9. Për rrjedhojë të sa arsyetuar më sipër, në kushtet kur nuk provohet pagesa e detyrimit tatimor në vitin 2008 për shitjen e truallit, si dhe faktin e mosdeklarimit të shumës 70.000 euro si likuiditet në gjendje *cash* në deklaratat e interesave privatë periodikë, trupi gjykues nuk e ka konsideruar të ligjshme të ardhurën e pretenduar dhe nuk e ka përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, për shlyerjen e shumës prej 45.000 eurosh në vitin 2011, për blerjen e apartamentit të vajzës së saj. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaram dhe mungesë burimesh të ligjshme që afektohet nga shitja e pretenduar e truallit nga ana e subjektit të rivlerësimit. Në përfundim për sa analizuar më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë apartament banimi ne emrin e vajzës Olivia Duka, në kuptim të nenit 33/5, geramat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

18. *Lidhur me pasurinë e luajtshme automjet “BMW”, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë mundësitë financiare të ligjshme për blerjen e këtij automjeti.*

18.1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, në ankim kundërshton konkluzionin e Komisionit duke pretenduar se ky automjet është blerë me të ardhurat e siguruara nga burime të ligjshme, dhe se ka provuar se, së bashku me bashkëshortin saj, kanë pasur plotësisht mundësinë financiare për blerjen e këtij automjeti.

18.2. Trupi gjykues, nga analizimi i deklaratës së pasurisë “vetting”, konstaton se kjo pasuri është deklaruar si vijon: *Autoveturë BMW x5 3.0D viti 2006, në emër të E. D., Nevrie Duka, sipas certifikatës së pronësisë së mjetit me nr. {***}, dt. 23.04.2012 (e blerë pas shitjes së autoveturës e markës “Land Rover”)*. Në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e blerjes së kësaj pasurie, ndërsa në deklaratën e interesave privatë të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri. Me qëllim verifikimin e mundësisë së justifikimit të blerjes së këtij automjeti (blerë pas shitjes së automjetit tip “Land Rover”), trupi gjykues vlerëson të marrë në analizë fillimisht dokumentacionin që vërteton të ardhurën e pretenduar nga shitja e automjetit “Land Rover”, nga ku konstaton si më poshtë.

18.3. Nga shqyrtimi i akteve në dosjen gjyqësore, rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë “vetting”, ka deklaruar: *Autoveturë e markës “Land Rover”, blerë më 13.05.2009 dhe shitur me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.04.2012*. Kjo pasuri është përfituar dhe tjetërsuar, konkretisht me kontratën e shitjes nr. {***} rep. dhe {***}kol., datë 22.01.2008, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka blerë automjetin e markës “Land Rover” kundrejt çmimit 500.000 lekë, kurse me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.04.2012, z. E. D. ia ka shitur këtë automjet z. G. D. (nipit të tij) në vlerën 10.000 euro. Nga analizimi i deklaratave të interesave privatë të vitit 2009 dhe 2012, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit ta ketë deklaruar këtë pasuri.

18.4. Lidhur me pasurinë automjet “Land Rover”, shitur në vitin 2012, në shumën 10.000 euro, nipit të tij G. D., rezulton se automjeti i markës “Land Rover” është ende në emër të z. E. D., policat e sigurimit për këtë automjet janë në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit i cili është pronar, asnjë nga policat e sigurimit nuk është në emër të z. G. D., qoftë dhe si përdorues, detyrim ligjor i parashikuar nga legjislacioni rrugor në fuqi. Automjeti është shitur në një vlerë shumë më të lartë se çmimi i blerjes pas kalimit të 4 vjetëve përdorim, duke ngritur dyshime për

shitje fiktive të këtij automjeti. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paguar detyrimet tatimore për të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti mbi çmimin e blerjes, si rrjedhojë, diferenca e shumë çmim shitje/çmim blerje e automjetit nuk është përfshirë në analizën financiare (sipas nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës), duke e vënë subjektin në kushtet e deklarimit të pasaktë, të paplotë dhe të rremë në lidhje me automjetin tip “Land Rover”, në kuptim të nenit D, pika 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, germat “a”, “b”, “ç” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

18.5. Subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, në ankim ka pretenduar se çmimi i shitjes është përcaktuar në marrëveshje me palët dhe kontrata është dokumenti që vërteton vlerën e shitjes së këtij automjeti dhe, sipas saj, bashkëshorti e ka blerë në gjendje jo të mirë mekanike dhe ka kryer shumë shërbime në të, në momentin e shitjes automjeti ka qenë në gjendje shumë më të mirë. Lidhur me pagimin e tatimit mbi të ardhurat, subjekti i rivlerësimit pretendon se në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, nuk parashikohet se fitimi i realizuar nga individët, nga shitja e automjeteve, është një e ardhur e tatueshme, në këtë kuadër Komisioni nuk mund ta kategorizojë këtë të ardhur si të tatueshme. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka qenë detyrim i blerësit të automjetit të kryente ndërrimin e pronësisë pranë DRSHTRR Sarandë, detyrim të cilin ai nuk e ka përmbushur.

18.6. Trupi gjykues vëren se nuk ka dokumentacion që provon pagimin e tatimit të fitimit mbi të ardhurat e realizuara si rezultat i shitjes së mjetit nga subjekti i rivlerësimit pas afro 4 vitesh, me një vlerë më të lartë se çmimi i blerjes. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues dhe të jetë bindës mbi shpenzimet e kryera për këtë mjet nga personi i lidhur (bashkëshorti), të cilat kanë çuar në rritjen më shumë se dyfishi të vlerës së tij. Diferenca e konsiderueshme mes çmimit të blerjes dhe çmimit të shitjes së këtij automjeti, e bën këtë transakcion të pabesueshëm, aq më tepër kur blerësi është nipi i tij. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se vlera e fitimit të realizuar nëpërmjet shitjes nuk mund të konsiderohet një e ardhur e ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk është i bazuar.

18.7. Në analizë të fakteve të mësipërme, si dhe duke marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, në kushtet kur ky automjet figuronte edhe pas shitjes së tij në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, si dhe i është shitur nipit të tij me një çmim më të lartë nga blerja, krijohet bindja se çmimi i referuar në kontratën e shitjes për automjetin “Land Rover”, nuk është real.

18.8. Trupi gjykues, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare për të provuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për blerjen e automjetit “BMW” më datë 12.04.2012. Rezultatet e analizës financiare treguan mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën 917.494 lekë. Në këto kushte, trupi gjykues gjen të pavërtetë deklarimin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, sa i përket të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti. Për sa konstatuar më lart, për automjetin “BMW X5”, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur (bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit E. D.), trupi gjykues vlerëson se *subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, si dhe ka kryer deklarim të rremë, sipas nenit 33/5, germat “b”, “ç” të ligjit nr. 84/2016.*

19. *Lidhur me pasurinë e luajtshme, mjetin tip “Skrep me gjithë çekiçin pneumatik-hidraulik”, blerë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. E. D.*, subjekti i rivlerësimit e konsideron të gabuar konkluzionin e Komisionit për mosmarrjen në konsideratë si burim të krijimit të kësaj pasurie depozitë në dollarë në Bankën Raiffeisen në vitin 2004, në shumën 13.000 USD, pavarësisht kësaj, subjekti i rivlerësimit pretendon se nëse në analizën financiare do të përfshihen të ardhurat e përfituara nga puna e bashkëshortit në shumën 3.000.000 lekë, atëherë do të rezultonte se familja Duka ka të ardhura të ligjshme për të blerë mjetin “skrep”.

19.1. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit në ankim, se i është drejtuar Komisionit me kërkesë për marrjen e informacionit mbi ekzistencën e llogarisë bankare pranë Bankës Raiffeisen ShA, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk është i bazuar, pasi dispozitat kushtetuese dhe ligjore, konkretisht neni Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, dhe neni 52 i ligjit nr. 84/2016 përcaktojnë qartësisht se barrën e provës në këtë proces, e ka subjekti i rivlerësimit. Është subjekti i rivlerësimit që ka detyrimin të deklarojë saktësisht çdo pasuri të deklaruar në pronësi ose në përdorim, si dhe të provojë me dokumentacion justifikues ligjor burimin e ligjshëm.

19.2. Në funksion të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues analizoi deklaratet e subjektit të rivlerësimit, nga ku rezultoi se në deklaratën e pasurisë “vetting”, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: *“skrep me gjithë çekiçin pneumatik-hidraulik, blerë nga E. D. me kontratën nr. {***}rep., nr. {***} kol., datë 03.04.2007, blerë 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro”*. Në këtë deklaratë nuk deklarohet burimi i krijimit. Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Është mbyllur depozita në Bankën Raiffeisen dhe shuma e tërhequr u përdor për të blerë një makineri të rëndë gjermuese skrep + çekiç*, te rubrika “Vlera në shifra dhe fjalë”, subjekti ka deklaruar: *13.000 (trembëdhjetë mijë) USD*. Në të njëjtën deklaratë periodike, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Është blerë një makineri e rëndë gjermuese (skrep + çekiç), në shumën 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro, pjesa në përqindje 50% me bashkëshortin*.

19.3. Nga verifikimi i akteve të administruara, gjatë hetimit administrativ në Komision, rezulton se me kontratën e shitjes nr. {***} rep, nr. {***} kol, datë 03.04.2007, z. E. D. ka blerë nga z. D. H. mjetin tip MH6 “Skrep”, i cili ka të instaluar çekiç pneumatik dhe frigorifer kundrejt çmimit 15.000 euro, shumë e cila sipas kësaj kontrate likuidohet me dy këste: këstin e parë prej 14.000 eurosh, blerësi E. D. ia ka likuiduar shitësit më datë 10.06.2006, ndërsa kësti i dytë prej 1.000 eurosh likuidohet ditën e firmosjes së kontratës, pra më 03.04.2007.

19.4. Në analizë të pretendimeve të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, trupi gjykues konstaton se, në lidhje me burimin e deklaruar për blerjen e mjetit “skrep”, Komisioni nuk ka evidentuar asnjë hapje depozite në dollarë në “Raiffeisen Bank” në vitin 2004, si dhe asnjë tërheqje apo mbyllje të kësaj depozite në vitin 2006, nga ana e subjektit të rivlerësimit apo bashkëshortit të saj. Për rrjedhojë, Komisioni nuk e ka përfshirë në analizën financiare të vitit 2004 këtë depozitë, pasi nuk është provuar ekzistenca e saj, si dhe nuk është konsideruar si burim për blerjen e “skrepit”, sikurse është deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006.

19.5. Nga shqyrtimi i fashikujve të përcjellë në Kolegj nga Komisioni dhe konkretisht në dokumentacionin e ILDKPI-së, rezulton se me datë 17.04.2015, është mbajtur procesverbali midis inspektorit të ILDKPI-së dhe subjektit të rivlerësimit, në të cilin ky i fundit në përgjigje të pyetjes se në cilën bankë ndodhej depozita dhe cili ka qenë burimi i saj është shprehur se do ta saktësojë dhe do të paraqesë dokumente mbështetës. Në procesverbalin e datës 05.05.2015, të mbajtur

përsëri me përfaqësuesit e ILDKPI-së, lidhur me këtë depozitë bankare, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se është ende në kërkim dhe do të mundohet të paraqesë dokumente provuese. Sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, burimi i krijimit të kësaj depozite është puna e bashkëshortit në Greqi që nga viti 1990.

19.6. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2006, si burim për blerjen e këtij mjeti, subjekti i rivlerësimit deklaroi mbyllje depozite dhe tërheqje në shumën 13.000 USD në Bankën Raiffeisen, por sikurse rezultoi nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, por dhe nga aktet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, nuk u provua ekzistenca e llogarisë bankare në Raiffeisen Bank ShA, që ka shërbyer si e ardhur për blerjen e mjetit “skrep”, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka dështuar të justifikojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm për blerjen e mjetit “skrep”.

19.7. Në analizë të pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit se nëse përfshihen të ardhurat e bashkëshortit, do të rezultonte se kishte mjaftueshëm të ardhura për blerjen e këtij mjeti, trupi gjykues, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare, me qëllim verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për blerjen e këtij mjeti, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi të përballonte krijimin e pasurisë mjet tip “skrep” në datën 10.06.2006, pasi rezultoi me një diferencë negative në vlerën -1.676.581 lekë.

19.8. Trupi gjykues, për sa më sipër, lidhur me mjetin tip “Skrep” në vlerën 15.000 euro, blerë në vitin 2007, i deklaruar në pronësi të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, çmon *se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaratimit të pasaktë në deklaratën vetting, dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë në kuptim të nenit 33/5, gerrat “a”, “b” të ligjit nr. 84/2016.*

20. Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit të deklaruara në deklaratën “vetting”, në shumën 22.750.000 lekë, Komisioni konkludoi se këto të ardhura nuk konsiderohen të provuara dhe të ligjshme, duke e vënë subjektin në kushtet e deklaratimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D, pikat 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, gerrat “a”, “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë, nuk i ka përfshirë ato në analizën financiare.

20.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat e bashkëshortit janë përfituar nga marrëdhëniet kontraktore (të punës/shërbimit apo qirasë) të lidhura me shoqëritë tregtare “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, të cilat i konfirmojnë shumat e përfituara, si dhe kanë marrë përsipër përgjegjësinë për pagimin e detyrimeve tatimore. Sipas subjektit të rivlerësimit, nuk ka asnjë parashikim ligjor që këto shoqëri të deklarojnë marrëveshjet e lidhura me një subjekt tregtar të regjistruar apo të paregjistruar në organet tatimore, por ato kanë detyrimin të deklarojnë çdo vit në organet tatimore bilancin me të ardhurat dhe shpenzimet përkatëse. Subjekti i rivlerësimit pretendon se e ka të pamundur të provojë nëse këto shoqëri i kanë përmbushur apo jo detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni tatimor, por, pavarësisht këtij fakti, nuk ka asnjë përgjegjësi për përmbushjen ose jo të detyrimeve tatimore nga ana e shoqërive. Sipas subjektit të rivlerësimit, mosregjistrimi i bashkëshortit në organet tatimore për aktivitetin e kryer, referuar nenit 112 të ligjit nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, është kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 10.000 lekë, në këtë mënyrë subjekti pretendon se dhënia e masës së

shkarkimit për një kundërvajtje administrative nuk përputhet me parimin e proporcionalitetit të parashikuar me ligjin nr. 84/2016.

20.2. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, nga verifikimi i akteve në dosjen gjyqësore, trupi gjykues konstaton faktet dhe rrethanat e mëposhtme lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

20.2.1. Në deklaratën e pasurisë “vetting”, në rubrikën “Përshkrimi i të ardhurave”, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: *të ardhura nga gjërmim + ngarkim + shkarkim + me mjete (skrep/çekiç/kamion) për periudhën 2005 deri në dhjetor 2016, sipas aktmarrëveshjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.02.2005, deklaratë nr. {***}, datë 24.04.2008, aktmarrëveshjen nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.03.2008, aktmarrëveshje datë 13.8.2014, aktmarrëveshje datë 3.2.2015, deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.05.2015, deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***}, datë 01.10.2015, aktmarrëveshje, datë 1.3.2016, në shumën 22.750 (njëzet e dy milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Nga analizimi i deklaratave të interesave privatë të viteve 2005 – 2016, rezulton që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat e bashkëshortit nga *punimet e gjërmimit me mjetin gjërmues dhe kamionin me vetëshkarkim.**

20.2.2. Në dokumentacionin e administruar gjenden disa aktmarrëveshje¹⁹ mes shoqërive të ndryshme ndërtuese dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, si dhe deklarata noteriale²⁰, nëpërmjet të cilave subjekti i rivlerësimit kërkon të provojë të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i saj.

Këto akte përmbajnë deklarime të përfaqësuesve ligjorë të shoqërive “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, si dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit mbi punimet e gjërmimit të kryera nga ky i fundit me mjetin skrep-çekiç, si dhe kryerjen e transportit me mjetin e tij kamion vetëshkarkues në objektet që këto shoqëri ndërtojnë me sipërmarrje, apo marrjen në përdorim të mjeteve të sipërcituara nga ana e këtyre shoqërive, duke përcaktuar edhe pagesat përkatëse për këto shërbime të kryera.

20.2.3. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, rezulton se, me shkresën nr. 1286 prot., datë 29.01.2020, Komisioni i ka kërkuar informacion shoqërisë “Arti” ShPK, duke i kërkuar dokumentacion teknik në lidhje me punimet e kryera nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, si: lejet e ndërtimit, aktet teknike të kohës që vërtetojnë kryerjen e punimeve ku të dalë qartë volumi, vlera e tyre, situacionet mujore të punimeve për periudhën 2005 – 2008, dhe objekti ku janë kryer këto punime, dokumentacionin kontabël, ndërsa në lidhje me qiranë i ka kërkuar pagesën e detyrimeve tatimore, si dhe dokumentacionin kontabël përkatës.

20.2.4. Shoqëria “{***}” ShPK, me shkresën nr. {***} prot., datë 13.02.2020, nëpërmjet administratorit të kësaj shoqërie, z. A. P, informon Komisionin se për ndërtimin e objekteve nga

¹⁹ Aktmarrëveshje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.02.2005; aktmarrëveshje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.03.2008, me palë shoqëria “{***}” ShPK, e përfaqësuar nga administratori S. C. dhe pala tjetër E. D.; aktmarrëveshje, datë 13.8.2014, lidhur midis shoqërisë “{***}” ShPK dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit; aktmarrëveshje, datë 03.02.2015, lidhur midis shoqërisë “{***}” ShPK dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit; aktmarrëveshje, datë 01.03.2016, lidhur midis shoqërisë “{***}” ShPK dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

²⁰ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.05.2015; deklaratë noteriale nr. {***}, datë 01.10.2015; deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.03.2018; deklaratë noteriale nr. {***}, datë 24.04.2008.

ana e kësaj shoqërie, janë përdorur mjetet e z. E. D., në përputhje me parashikimet e marrëveshjes, por nuk disponon dokumentacion në lidhje me punimet dhe pagesat e kryera, pasi ka kaluar kohë e gjatë dhe, bazuar në nenin 17 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe në nenin 116²¹, pika 1 e ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, këto dokumente ruhen për një afat 10-vjeçar.

20.2.5. Me shkresën nr. {***} prot., datë 29.01.2020, Komisioni i ka kërkuar informacion shoqërisë “{***}” ShPK duke i kërkuar të njëjtin dokumentacion si më sipër. Në shkresën kthim përgjigje të saj nr. {***} prot., datë 10.02.2020, të firmosur nga administratori S. C., kjo shoqëri informon Komisionin duke pranuar faktin se ka përdorur mjetin e z. E. D. për nevoja të kësaj shoqërie, në përputhje me marrëveshjen nr. {***}, datë 25.03.2008, si dhe ka paguar detyrimet tatimore, por nuk disponon asnjë dokumentacion bazuar në të njëjtat akte ligjore, sikurse citon shoqëria “{***}” ShPK në shkresën e saj.

20.2.6. Gjithashtu, Komisioni, me qëllim sqarimin e situatës së deklarimeve tatimore nga ana e këtyre shoqërive, i është drejtuar me shkresën nr. {***} prot., datë 05.02.2020, Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, e cila, me shkresën kthim përgjigje nr. {***}, datë 14.02.2020, sqaron Komisionin se punimet e kryera nga z. E. D. konsiderohen veprimtari tregtare dhe për këto të ardhura të përfituara ka lindur detyrimi tatimor. DRT-ja Sarandë konfirmon se shoqëritë “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, megjithëse kishin detyrimin ligjor për të deklaruar marrëveshjet me z. E. D. për pjesën që ka lidhje me deklaratimet e pagimeve tatimore, rezulton se nuk janë deklaruar pranë kësaj drejtorie.

Sipas shkesës së DRT-së Sarandë, detyrimin për deklarimin e pagesës së tatimit në burim e ka subjekti i regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore. Pagesat për detyrimet e lindura nga kontratat e qirave ose marrëveshjeve deklarohen në rubrikën e tatimit në burim, por sipas kësaj shkrese, shoqëritë “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK nuk kanë deklaruar pagesa për qiratë ndaj të tretëve.

20.3. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, si gjatë hetimit administrativ në Komision por dhe më pas, nuk arriti të provojë me dokumentacion provues kryerjen e punimeve nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, mënyrën dhe kohën e shumave të përfituara nga këto shoqëri, volumin e kryer, lejet e ndërtimit, situacionet mujore të punimeve si dhe aktet teknike të kohës, ashtu siç pretendohet për punën e kryer referuar në aktmarrëveshjet e mësipërme apo deklaratat noteriale të firmosura nga palët. Gjithashtu subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion që do të vërtetonte pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara të përfituara nga bashkëshorti i saj në marrëdhëniet kontraktore me shoqëritë “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK.

20.4. Referuar nenit 6, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar²², trupi gjykues vlerëson se bashkëshortit të subjektit të

²¹ “Periudha, gjatë së cilës personi i tatueshëm duhet të sigurojë ruajtjen e faturave që lidhen me furnizimet e mallrave apo të shërbimeve, të kryera në territorin e Shqipërisë, si edhe të atyre të marra nga ana e personave të tatueshëm apo jo të tatueshëm, të vendosur në Republikën e Shqipërisë, është 5 vite të plota kalendarike, duke filluar nga viti që pason vitin kur lëshohet fatura”.

²² “Detyrimi tatimor lind kur personi realizon të ardhura, kur bëhet pronar i një pasurie apo kryen pagesa, të cilat janë objekt i tatimit, sipas legjislacionit tatimor. 2. Detyrimi tatimor lind edhe kur personi realizon të ardhura, kryen pagesa, në formë të jashtëligjshme, apo bëhet zotëruar i një sendi, në formë të jashtëligjshme. Kur personi bëhet

rivlerësimit i ka lindur detyrimi për pagesën e detyrimeve tatimore si përfitues i të ardhurave të pretenduara nga marrëdhëniet me shoqëritë “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, detyrime të cilat nuk u vërtetuan nga ana e subjektit të rivlerësimit me dokumentacion justifikues. Në zbatim të nenit 40, pikat 1, 2 të ligjit nr. 9920/2008²³, si dhe pikës 40 të udhëzimit të Ministrisë së Financave, nr. 24, datë 2.9.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit kishte detyrimin ligjor për t’u regjistruar në organet tatimore për veprimtarinë ekonomike të cilën kryente.

20.5. Në përgjigje të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se, referuar aktmarrëveshjeve dhe deklaratave noteriale me këto shoqëri, detyrimet tatimore për të ardhurat e përfituara nga puna e bashkëshortit merren përsipër nga ana e shoqërisë dhe subjekti nuk ka pasur përgjegjësi dhe detyrim për kryerjen e pagesave të detyrimeve tatimore, trupi gjykues thekson se është i pambështetur dhe në kundërshtim me përcaktimet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, ku përcaktohen si të ardhura të ligjshme ato të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, detyrim ky i përcaktuar dhe në pikën 22 të udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016”²⁴.

20.6. Trupi gjykues, bazuar në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon: *[...] Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji, konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore [...]*, vlerëson se nuk mund të konsiderohen si të ligjshme të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, dhe pasojat ligjore për këto të ardhura që janë deklaruar si burim për krijimin e pasurive të mëvonshme, për efekt të procesit të rivlerësimit, nuk plotësojnë kriteret e parashikuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 30 i ligjit nr. 84/2016, për t’u konsideruar si të ardhura të krijuara nga një burim i ligjshëm dhe për të cilat të jenë paguar detyrimet tatimore, sipas legjislacionit përkatës në fuqi, në kohën e krijimit. Në këtë mënyrë, për efekt të provueshmërisë së kriterëve ligjore, në përputhje me nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjektet e rivlerësimit kanë detyrimin që, në rastet e deklarimit si burim krijimi të pasurive të tyre të ardhurat, të paraqesin të gjitha dokumentet që provojnë burimin dhe justifikojnë ligjshmërinë e tij, referuar kjo dhe praktikës së konsoliduar të Kolegjit²⁵.

20.7. Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit E. D., trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e

zotërues i një sendi në forma të jashtëligjshme, ky detyrim përllogaritet për të gjithë periudhën në të cilën personi ka gëzuar frytet e kësaj pasurie”.

²³ *Personat fizikë dhe juridikë ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare vetëm pas regjistrimit të tyre, në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”. Një person fizik me të njëjtin numër të identifikimit personal regjistrohet vetëm një herë nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Atij i lind e drejta të regjistrohet dhe të pajiset me një NIPT/NUIS të ri nga Qendra Kombëtare e Biznesit, vetëm mbas çregjistrimit të NIPT-it/NUIS-it ekzistues. 2. Personat e regjistruar sipas këtij ligji pajisen me numër identifikimi unik, të gjeneruar elektronikisht, i cili shërben si numër i identifikimit tatimor të tyre, për tatimet kombëtare dhe vendore.*

²⁴ *Deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga aktiviteti privat i subjektit të rivlerësimit dhe/ose personave të lidhur me të, të shoqërohet për periudhën e deklaruar me dokumentacionin justifikues ligjor nga zyrat e tatim taksave për fitimin e realizuar dhe dividendin e tërhequr”.*

²⁵ *Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6/2019 (JR), datë 28.02.2019, paragrafi 21.12; nr. 23/2020 (JR), datë 25.09.2020, paragrafi 25.4.*

bashkëshortit, të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe, për pasojë, nuk provohen saktësisht të ardhurat reale të përfituara prej tij, për këto arsye *subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën vetting në kuptim të nenit 33/5, germa "a" e ligjit nr. 84/2016.*

21. Lidhur me analizën ekonomike dhe financiare për vitet 2003-2016, Kolegji analizoi shkaqet ankimore të subjektit të rivlerësimit, në kronologji sipas viteve, dhe konstatoi si më poshtë vijon.

21.1. Lidhur me konstatimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, nuk e ka deklaruar huan e dhënë motrës së saj në shumën 3000 paund britanikë [GBP], në deklaramin e interesave privatë të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit pretendon se kjo ka ndodhur pasi ato kanë qenë shuma të vogla të dhëna ndër vite motrës së saj dhe nuk mendonte se motra mund t'ia kthente në të ardhmen. Trupi gjykues konstatoi se në deklaratën e interesave privatë të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *3000 paund të dërguara nga motra si borxh i pashlyer ndër vite ndaj meje*, si dhe referuar vendimit objekt shqyrtimi, nuk rezulton që Komisioni të ketë ngarkuar me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, por vetëm ka cituar konstatimin e ILDKPI-së për mosdeklaram të kësaj shume në deklaratën e interesave privatë të vitit 2003. Në analizën financiare të kryer në Kolegj, kjo shumë është përfshirë si e "ardhur" për vitin 2005.

21.2. *Lidhur me dhënien e huas në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) USD*, Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshme dhënien e huas në shumën 30.000 USD z. A. D., dhe kthimin e saj, duke kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D, pikat 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, gerrat "a" dhe "b", si dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

21.2.1. Për këtë konkluzion të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, pretendon se bashkëshorti i saj të ardhurat për dhënien hua i ka siguruar nga puna e ligjshme në emigracion para martesës, por që nuk mund t'i provojë këto të ardhura të përfituara 20 vite më parë. Subjekti i rivlerësimit sqaron se kjo hua është dhënë nga bashkëshorti i saj në vitin 2005, vëllait të tij, z. A. D., me qëllim që ai të blinte një apartament, por sipas subjektit, z. A. D. (vëllai i bashkëshortit) e prishi marrëveshjen për blerjen e shtëpisë dhe i ktheu lekët në vitin 2006, këtë fakt subjekti e mbështet me deklaratën noteriale nr. {***}, datë 27.05.2009, të z. A. D. që vërteton kthimin e saj z. E. D. në vitin 2006, si dhe në deklaratën noteriale nr. {***}, datë 18.12.2019, të z. A. D dhe znj. A. D..

21.2.2. Nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore, trupit gjykues i rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka deklaruar se: *Me deklaratën noteriale nr. {***}, datë 27.5.2009, z. A. D. deklaron se i ka kthyer E. D., shumën prej 30.000 USD qysh në shkurt 2006.* Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *30.000 dollarë amerikanë, të dhëna nga bashkëshorti im të vëllait të tij A. D. me një deklaratë dore me afat 5-vjet.* Me deklaratën noteriale të datës 27.05.2009 me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., z. A. D. deklaroi se i ka marrë 30.000 dollarë E. D. dhe ia ka kthyer këtë hua në muajin shkurt 2006 *cash*, ndërkohë që kthimi i huas nuk rezultoi i deklaruar në deklaratën e interesave privatë vjetorë 2006.

21.2.3. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor, të ardhurat e bashkëshortit nga emigracioni, të cilat kanë shërbyer për dhënien e huas në shumën

30.000 USD, si dhe në kushtet kur në deklaratën e pasurisë 2003 nuk ka deklaruar kursime në *cash* nga puna e bashkëshortit në emigracion, të cilat as nuk janë deklaruar e as provuar me dokumentacion justifikues ligjor, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për origjinën e këtyre të ardhurave mbetet në nivel deklarativ dhe ato nuk janë përfshirë në analizën financiare të kryer në Kolegj për vitin 2005, pasi nuk plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për t'u konsideruar të ligjshme.

21.2.4. Trupi gjykues, në zbatim të nenit 32 të pikës 1 të ligjit nr. 84/2016²⁶, si dhe pikës 21 të udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, e vlerëson të drejtë konstatimin e Komisionit për mosjustifikimin me burime të ligjshme të dhënies së huas në shumën 30.000 USD nga ana e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, pasi subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, nuk arriti t'i provojë me dokumentacion justifikues, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe më pas, të ardhurat e pretenduara të përfituara nga puna në emigracion e bashkëshortit të saj. Sipas analizës financiare, subjekti i rivlerësimit rezulton me diferencë negative për vitet 2005 dhe 2006 dhe me pamundësi financiare për dhënien e kësaj huaje, për rrjedhojë shkak i ankimit për këtë hua, konsiderohet i pabazuar në prova dhe ligj.

21.2.5. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj për vitin 2005, subjekti i rivlerësimit rezulton me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme në vlerën 2.476.339 lekë për të krijuar pasuri, për të përballuar shpenzimet e jetesës e të tjera, si dhe për dhënien e huas 30.000 USD të vëllait, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016.

21.3. *Lidhur me mosdeklarimin në deklaratën periodike të vitit 2005 të depozitës në shumën 935.700 lekë, të depozituar në llogarinë e "Raiffeisen Bank" më datë 24.08.2005*, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se është një lapsus, i cili në kushtet kur është plotësisht i verifikueshëm, nuk mund të konsiderohet se është kryer me dashje. Në rast se do të merren në konsideratë të ardhurat e deklaruara të bashkëshortit, subjekti i rivlerësimit pretendon se do të rezultojë me të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar këtë depozitë.

21.3.1. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, lidhur me llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit në Raiffeisen Bank ShA²⁷, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka tërhequr në datën 24.08.2005 të gjitha depozitat e maturuara në këtë bankë që nga viti 2004, në shumën totale prej 631.059,26 lekësh, ku shtesa për vitin 2005 është në vlerën 304.640,74 lekë, në të njëjtën datë subjekti i rivlerësimit ka derdhur në llogari vlerën 935.700 lekë, të cilën e ka tërhequr një ditë më pas, më 25.08.2005. Shumën e tërhequr nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit ta ketë deklaruar si gjendje *cash* në banesë në deklaratën e interesave private të vitit 2005.

21.3.2. Trupi gjykues çmon se mosdeklarimi i kësaj depozite bankare nga ana e subjektit të rivlerësimit është në kundërshtim me detyrimin e tij si subjekt deklarues, detyrim i cili rrjedh nga neni 4, germa "d" e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, ndërsa lidhur me burimin e krijimit të kësaj shume të pretenduar si të përfituar nga të ardhurat e bashkëshortit, trupi gjykues në vijimësi të qëndrimit të mbajtur më sipër mbi ligjshmërinë e të ardhurave të bashkëshortit, vlerëson se për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk arriti të vërtetonte pagesën e detyrimeve tatimore mbi këto të

²⁶ Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

²⁷ Shkresa nr. {***}, datë 10.12.2019.

ardhura, ato nuk mund të konsiderohen të ligjshme, referuar pikës 3, nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

21.4. *Lidhur me dhënien hua të shumës prej 5.000 USD në vitin 2006, znj. K. D. nga ana e subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka justifikuar me burime të ligjshme dhënien e kësaj huaje, si dhe nuk e ka deklaruar huan e dhënë në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë të vitit 2006, për pasojë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, germat “a” dhe “b”, si dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*

21.4.1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, në ankimin e paraqitur, pretendon se mosdeklarimi i kësaj huaje në vitin 2006 është i paqëllimshëm dhe, nëse do të merren në konsideratë të ardhurat e bashkëshortit nga puna e kryer e tij, si dhe të ardhurat e dërguara nga motra e saj në Angli, atëherë të ardhurat e deklaruara dhe të përfituara do të mbulonin shumën e dhënë hua.

21.4.2. Trupi gjykues, sa i përket këtij shkakui ankimor, konstaton se në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Në vitin 2006 i kam dhënë një shoqes sime, K. D., shumën prej 5.000 USD hua. Nuk m’i ka kthyer akoma. Janë dhënë në mirëbesim, pa dokument.* Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2006, subjekti nuk e ka deklaruar dhënien e kësaj huaje. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi nga ana e subjektit të rivlerësimit i kësaj huaje në deklaratën periodike të vitit 2006, bie në kundërshtim me detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 4, pika 1, germa “d” e ligjit nr. 9049/2003²⁸.

21.5. Lidhur me depozitën e hapur më datë 23.06.2006, në vlerën 20.000 USD në Procredit Bank ShA, për të cilën Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka justifikuar me burime të ligjshme depozitim të kësaj shume në vitin 2006, duke kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, subjekti i rivlerësimit pretendon se mospasqyrimi në analizën financiare të Komisionit i të ardhurave të bashkëshortit në vitet 2005 dhe 2006, të ardhurat e kthyer dhe të dhëna hua nga bashkëshorti në vitin 2005, të ardhurat e kthyer nga motra e saj, e nxjerrin në konkluzion të gabuar vendimmarrjen e Komisionit. Subjekti kërkon nga Kolegji kryerjen e një analize të re financiare, nga e cila subjekti pretendon se do të realizojnë burime të mjaftueshme për depozitim të kësaj shume.

21.5.1. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupit gjykues i rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2006, deklaroi: *Është hapur një librezë kursimi dt.23.06.2006 tek Procredit Bank (të mbledhura kryesisht nga bashkëshorti nga puna me kamionin e blerë me kredi).* Vlera në shifra “20.000 (njëzet mijë USD). Pjesa takuese: 30% subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, dhe 70% bashkëshorti i saj. Kolegji, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare deri në momentin e depozitimit të shumës në datën 23.06.2006, me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për krijimin e shumës 20.000 USD. Në analizën financiare nuk u morën në konsideratë të ardhurat e bashkëshortit [shih paragrafin 20 të këtij vendimi], si dhe të ardhurat e pretenduara të kthyer nga motra e saj, të cilat nuk u deklaruan si gjendje *cash* në banesë në deklaratën e interesave privatë të vitit 2005. Rezultatet e analizës

²⁸ *Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare.*

financiare treguan se subjekti i rivlerësimit nuk kishte burime të ligjshme financiare në vlerën 2.276.210 lekë për krijimin e depozitës në shumën 20.000 USD.

21.5.2. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj për vitin 2006, subjekti i rivlerësimit rezultoi me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për të krijuar pasuritë, përfshirë këtu depozitën në vlerën 20.000 USD, dhënien e huas në vlerën 5.000 USD, si dhe mbulimin e shpenzimeve për vitin 2006, në vlerën (-) 4.416.103 lekë.

21.6. *Lidhur me pasurinë autoveturë “Mercedes - Benz”,* Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka paguar detyrimet tatimore për të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti mbi çmimin e blerjes, si rrjedhojë diferenca e shumës çmim shitje/çmim blerje e automjetit nuk është përfshirë në analizën financiare (sipas nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës).

21.6.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, nuk parashikohet se fitimi i realizuar nga individët, nga shitja e automjeteve është një e ardhur e tatueshme, në këtë kuadër, Komisioni nuk mund ta kategorizojë këtë të ardhur si të tatueshme.

21.6.2. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupit gjykues i rezulton se automjeti “Mercedes - Benz” është blerë nga bashkëshorti i subjektit i rivlerësimit me kontratën e shitjes nr. {***} rep. dhe {***} kol., datë 02.04.2004, në vlerën 250.000 lekë dhe është shitur me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.1.2008, për shumën 500.000 lekë.

21.6.3. Lidhur me çmimin e shitjes, subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor punimet e kryera që kanë çuar në përmirësimin e gjendjes teknike të mjetit, sikurse pretendon në ankimin e paraqitur, që kanë sjellë për pasojë shitjen më shtrenjtë të tij duke realizuar fitim. Për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e automjetit (trajtuar dhe në paragrafin nr. 18 të këtij vendimi), nuk u provua pagimi i detyrimit tatimor mbi këtë fitim²⁹, për rrjedhojë trupi gjykues vlerëson se vlera e fitimit të realizuar rezulton të jetë e ardhur e paligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

21.7. *Lidhur me dhënien e huas, në shumën 35.734 USD, z. L. S. dhe kthimin e saj në shumën 39.307 USD,* subjekti i rivlerësimit e konsideron të gabuar qëndrimin e Komisionit për mosmarrjen në konsideratë të të ardhurave të përfituara nga shitja e truallit prej 400 m² në vitin 2008, të cilat, sipas tij, kanë shërbyer si burim për dhënien e kësaj huaje.

21.7.1. Nga analizimi i dokumentacionit të fashikullit gjyqësor, rezulton se me kontratën e huas nr. {***} prot., datë 04.03.2008, z. E. D., në cilësinë e huadhënësit, i ka dhënë huamarrësit, z. L. S., shumën prej 35.734 (tridhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër) dollarësh amerikanë. Palët kanë rënë dakord që huaja të jepet me 10% interes fitimi të shumës së dhënë, duke u detyruar huamarrësi t’i kthejë pas një viti, më datë 03.03.2009, z. E. D., shumën e të hollave bashkë me interesin e fitimit të huas, në vlerën prej 39.307 dollarësh amerikanë. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë për vitin 2008, ka deklaruar: *Shuma prej 35.734 USD iu dha hua z. L. S. për një afat 1 vit, 04.03.2008 – 03.03.2009*, ndërsa në deklaratën e interesave privatë të vitit

²⁹ Vendimi nr. 34/2019 (JR), datë 02.12.2019, paragrafi 65.4 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

2009, deklararon: *u kthye shuma e dhënë hua te z. L. S., së bashku me interesat, në vlerën totale 39.307 USD.*

21.7.2. Në vlerësim të shkakut ankimor të subjektit të rivlerësimit, se burim për dhënin e huas kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e truallit prej 400 m² nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {***}, datë 28.5.2008, trupi gjykues në linjë me Komisionin, konstaton se burimi i të ardhurave për dhënien e huas z. S., nuk mund të kenë qenë të ardhurat e siguruara nga shitja e truallit, pasi ato, sipas deklaratës noteriale të sipërcituar, janë marrë në datën 26.5.2008, ndërkohë që huaja rezulton të jetë dhënë më shumë se dy muaj më parë, në datën 04.03.2008, duke e bërë të pabazuar shkakun e ankimit të subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për dhënien e huas në shumën 35.734 USD, sepse provat dhe aktet e paraqitura mbi këtë shkak nuk konsiderohen si dokumentacion justifikues ligjor mbi burimin e ligjshëm të dhënies së huas z. L. S.. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit në ankim se këtë hua mund ta jepte edhe nga kursimet e viteve më parë, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime në asnjë vit deri në vitin 2008 kur ka dhënë këtë hua. Subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, në deklarimin e saj nuk e shpjegon mënyrën dhe burimin se nga cilat të ardhura duhet të përlllogariten këto kursime.

21.7.3. Lidhur me kreditë në shumat 700.000 lekë dhe 400.000 lekë, përkatësisht në datat 20.4.2010 dhe 28.5.2014, në emrin Nevrie dhe E. D., Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratat periodike marrjen e këtyre kredive. Subjekti i rivlerësimit nuk provon me dokumentacion provues që këto dy kredi i janë dhënë vëllait të bashkëshortit të saj, por provohet që shumat 700.000 lekë dhe 400.000 lekë janë përdorur nga subjekti i rivlerësimit, ndryshe nga sa është deklaruar në deklaratën e pasurisë “vetting”, provohet që kredia në shumën 700.000 lekë nuk është përdorur nga vëllai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. A. D., për shlyerjen e këtyre kredive, për pasojë subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, germat “a” dhe “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

21.7.4. Subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, pretendon se arsyeja e mosdeklarimit të këtyre kredive është fakti se këto kredi ia ka kaluar vëllait të bashkëshortit dhe nuk e ka konsideruar dhe deklaruar si detyrim, por njëkohësisht as si të ardhur pasi ato kredi nuk janë përfituar dhe përdorur nga ana e saj, meqenëse këto kredi janë shlyer dhe mbyllur nga A. D. dhe A. D.. Subjekti i rivlerësimit pretendon se pavarësisht këtij fakti, nëse në analizën financiare do të përfshiheshin të ardhurat e bashkëshortit, atëherë do të konkludohej se të ardhurat e familjes Duka kanë qenë më se të mjaftueshme për të shlyer kreditë e marra.

21.7.5. Trupi gjykues, pas analizimit të akteve, konstatoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, dhe bashkëshorti i saj kanë marrë dy kredi pranë Raiffeisen Bank ShA, përkatësisht në datën 20.04.2010, në vlerën 700.000 lekë dhe në datën 28.05.2014, në vlerën 400.000 lekë. Sipas gjendjes së llogarisë bankare, kredia e parë është disbursuar në llogari bankare në datën 20.04.2010 në llogarinë e subjektit të rivlerësimit, në të cilën gjendja e llogarisë para disbursimit të kredisë

ishite në vlerën -238,672.75 lekë. Me disbursimin e kësaj kredie llogaria krijoi një tepricë kreditore në vlerën 461.327.25 lekë. Në datën 20.04.2010, nga llogaria e subjektit të rivlerësimit është transferuar në llogarinë e znj. V. H. C., shuma prej 400.000 lekësh.

21.7.6. Trupi gjykues konstaton se për të dyja këto kredi, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar asnjë shpenzim për pagesën apo për destinacionin e tyre në asnjë nga deklaratat periodike vjetore të pasurisë, si dhe nuk provohet me dokumentacion kalimi i kësaj kredie te vëllai i bashkëshortit, ashtu siç pretendon subjekti i rivlerësimit, për rrjedhojë këto kredi në analizën financiare të kryer në Kolegj, janë përlllogaritur si të konsumuara nga subjekti i rivlerësimit dhe gjithashtu në secilin vit janë reflektuar shpenzimet e pagesave të këtyre kredive. Referuar nenit 4, pika 1, germa “dh” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, por edhe jurisprudencës së Kolegjit³⁰, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin për deklarimin e kredive të sipërcituara në deklaratat vjetore periodike, për rrjedhojë trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për mosdeklarimin e kësaj kredie.

21.8. Subjektit i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se nuk ka justifikuar me burime të ligjshme gjendjen *cash* në shumën 1.300.000 lekë, me pretendimin se ka pasur si burim të kursimit të ardhurat e bashkëshortit dhe pagat e saj.

21.8.1. Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues në lidhje me krijimin e kursimeve *cash* në shumën 2.400.000 lekë në vitin 2014, nuk ka deklaruar në asnjë prej deklaratave periodike deri në vitin 2014 kursime *cash*, si dhe nuk ka pasur mundësi financiare për krijimin e gjendjes *cash* për vitet 2014, 2015 dhe 2016, duke kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, gjerat “a” dhe “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

21.8.2. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Kam gjendje cash në shumën 1,3 (një presje tre) milion lekë si kursime, 500.000 lekë nga viti 2015 dhe 800.000 lekë nga viti 2016, si burim të krijimit të tyre të ardhurat e bashkëshortit dhe nga paga e saj, në deklaratat e interesave privatë periodikë, rezultojnë që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar si në vijim.*

Në DIPPV-në e vitit 2014: *Kursime për vitin 2014 [...] 2.400.000 (dy milionë e katërqind mijë) lekë [...]. Për vitet e tjera më përpara, nuk i kam shkruar se sa kam kursyer në vit, pasi nuk e dija se kjo ishte faqja ku mund t'i deklaroja. Gjithsesi, është lehtësisht e provuar.*

³⁰ Vendimi nr. 25/2021(JR), datë 29.07.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Ardian Ylli, paragrafi 22.1: “[...] kjo lidhet drejtpërdrejt me përgjegjësinë që kanë subjektet deklaruuese për të përmbushur detyrimet ligjore të parashikuara nga ligji nr. 9049/2003, megjithatë, kontrolli i saktësisë së plotësisë të deklaratave të interesave privatë periodike vjetorë nuk është objekt i zbatimit të ligjit nr. 84/2016, me pasojë dhënien e masës disiplinore. Vlerësimi i përmbajtjes së tyre si prova bëhet vetëm në funksion të kontrollit të saktësisë së plotësisë të deklaratës së pasurisë *vetting* [...]”.

Në DIPPV-në e vitit 2015 subjekti ka deklaruar: *Kursime për vitin 2015 [...] 500.000 (pesëqind mijë) lekë*, ndërsa në DIPPV-në e vitit 2016 subjekti ka deklaruar: *Kursime për vitin 2016 [...] 800.000 (tetëqind mijë) lekë*.

21.8.3. Trupi gjykues, pasi konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendjen *cash* në deklaratat e interesave privatë periodikë para vitit 2014, e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit *se nuk ka deklaruar kursime para vitit 2014, pasi nuk ka pasur asnjë rubrikë ku të përcaktohej gjendja cash, në depozitë apo llogari rrjedhëse*, pasi në deklaratat periodike vjetore, në rubrikën “Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit” kërkohet të pasqyrohet vlera në lekë apo valutë [...], në mungesë të dokumenteve vlerën që keni shtuar apo pakësuar [...], gjë e cila, sikurse rezulton, nuk është plotësuar nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave privatë periodikë para vitit 2014.

21.9. Lidhur me huan e dhënë në vitin 2015, subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, pretendon se mosdeklarimi i dhënies së huas vëllait të bashkëshortit të saj në shumën 15.000 euro në deklaratën e pasurisë *vetting*, është harresë dhe nuk ka pasur për qëllim fshehjen e saj duke sjellë praktikën e Komisionit dhe Kolegjit, se harresat të cilat nuk kanë si qëllim fshehjen, mund të kuptohen pasaktësi në kuptim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues çmon të theksojë se tashmë Kolegji ka qëndrim të konsoliduar mbi rëndësinë dhe përgjegjësinë që kanë subjektet e rivlerësimit në plotësimin e deklaratës për efekt të procesit të rivlerësimit.

21.9.1. Në deklaratën vjetore periodike për vitin 2015, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Shuma 15.000 euro i është dhënë hua vëllait të bashkëshortit G. D., për një afat trevjeçar, për nevoja të kompletimit të objektit që ka ndërtuar në zonën {***}*. Nuk rezulton e deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit kjo hua në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe nuk ka paraqitur dokumentacion apo të dhënë si në Komision, ashtu dhe në ankimin e paraqitur për mundësinë financiare për dhënien e kësaj huaje, për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, nuk ka justifikuar burimin e ligjshmërisë së huas së dhënë vëllait të bashkëshortit të saj, në vlerën 15.000 euro.

21.9.2. Nga analiza financiare për vitet 2015 dhe 2016, e kryer në Kolegji, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi të përballonte shpenzimet dhe krijimin e kursimeve për këto vite dhe gjithashtu dhënien e huas në shumën 15.000 euro vëllait të bashkëshortit, për diferencat negative në vlerat 356.605 lekë për vitin 2015 dhe 1.957.358 lekë për vitin 2016, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

22. Në përfundim, referuar sa më sipër, Kolegji kreu analizën ekonomiko-financiare për vitet 2003-2016, nga e cila subjekti i rivlerësimit, rezultoi me një diferencë negative në shumën 18.907.816 lekë, trupi gjykues i Kolegjit thekson që e gjen të konfirmuar diferencën negative që ka rezultuar nga analiza e kryer në Komision në vlerën 17.419.035 lekë. Kolegji vlerëson se, sipas kësaj analize ekonomiko-financiare, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të

ligjshme për të justifikuar pasuritë, kursimet dhe shpenzimet e krijuara në këto vite, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

23. Për arsyet e mësipërme, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, vendimi nr. 253, datë 12.03.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i mbështetur në ligj e në prova dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 253, datë 12.03.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Nevrie Duka (Halo).
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 18.05.2022.

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi